



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 KORRIK 2011**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
28 JULA 2011. GODINE**

**KORRIK – JULI
2011**

E enjte, 28.7. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Ne po ia fillojmë punës, po i kalojmë disa pika të rendit të ditës dhe po shkojmë atje ku nuk kemi nevojë të kemi kuorum.

Ju njoftoj për pikën 4, për nënshkrimin e marrëveshjes.

4. Ratifikimi i Marrëveshjes për llogarinë e Trustit në mes të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës lidhur me ndihmën zhvillimore përmes Programit për arsim themelor,

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se presidentja e Republikës së Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen për llogarinë e Trustit në mes Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës lidhur me ndihmën zhvillimore përmes Programit për arsim themelor.

Marrëveshja Kuvendit i është proceduar për njoftim. Kjo ishte për njoftimin tuaj.

Kalojmë prej pikës së pestë, se na duhen dy të tretat e kuoromit, shkojmë te pika e gjashtë:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, zotin Blerand Stavileci, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministër e ke fjalën.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: I nderuar kryetar Krasniqi,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush ta prezantoj Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Prodhimtaria e kulturës industriale të duhanit, në krahasim me vitet e 90-ta, ka pësuar rënie për shumë arsye, mirëpo njëra prej tyre është edhe mungesa e një projektligji adekuat, i cili stimulon rritjen e prodhimtarisë së kësaj kulture industriale dhe siguron konkurrencë të barabartë në treg.

Për ta rregulluar në mënyrë sa më të mirë zhvillimin e kësaj veprimtarie ekonomike, ne kemi rishikuar kornizën aktuale ligjore dhe i kemi plotësuar mangësitë e saj nëpërmjet një kornize të re, e cila është më e avancuar, si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë praktik duke vënë në përputhshmëri të plotë edhe me legjislacionin e BE-së dhe standardet e avancuara ndërkombëtare.

Krijimi i kësaj kornize ligjore është bërë duke u mbështetur në parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me: prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit të papërpunuar dhe produkteve të tij dhe përbën bazën e vendosjes së ligjshmërisë për rregullimin e marrëdhënieve juridike që lidhen me procedurat, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve në këtë fushëveprimtari.

Një pjesë e madhe e popullsisë, në veçanti në disa regjione të vendit tonë, ka pasur traditë të begatshme në kultivimin e kësaj kulture. Në raport me kulturat e tjera bujqësore, kjo kulturë industriale është mjaft profitabile, mirëpo nevojitet një kontroll më i madh për të mundësuar që produktet e duhanit të tregtohen vetëm nga subjektet e licencuara.

Prandaj, gjatë hartimit të këtij projektligji pikësypnim kryesor ka qenë shtjellimi ligjor i gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me kompletimin e një strukture përmbajtjesore duke përcaktuar shumë qartë objektivat dhe masat në kuadër të politikave bujqësore si dhe përgjegjësitë e autoriteteve kompetente për zbatimin e tij.

Në aspektin financiar duhet theksuar se për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore dhe pasi që organet e parapara për themelimin ekzistojnë, nuk nevojitet as plotësimi i tyre me burime njerëzore.

Për më tepër nëpërmjet zbatimit të këtij projektligji në veçanti nënëve brenda krerëve VII dhe IX, do të gjenerohen mjete të konsiderueshme për buxhetin.

Për sa i takon aspektit teknik ky projektligj ka dhjetë kapituj me gjithsej 38 nënë. Për hartimin e tij si modele bazë janë marrë ligji slloven, austriak dhe ai gjerman dhe po ashtu të gjitha çështjet e adresuara në këtë projektligj janë në harmoni me dy rregulloret e Këshillit numër 2075/92 dhe Rregulloren tjetër numër 1636/98.

Prandaj, miratimi i këtij projektligji është në interesin e përgjithshëm të zhvillimit të bujqësisë, sepse krijon stabilitet legjislativ në fushën të cilën e rregullon. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Kryetari i Komisionit e do fjalën.

Deputeti Nait Hasani, e ka fjalën në emër të Komisionit funksional.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, në mbledhjen e mbajtur më 13.7.2011, ka shqyrtuar në parim Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit dhe ka vendosur që seanca ta miratojë në parim këtë projektligj dhe ne jemi për bashkëpunim edhe për përcjellje të mëtejshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e kryetarëve të grupeve parlamentare. Po shpresoj që natyrën e shpjegimit dhe rëndësinë e ligjit e dha ministri, deputetët në parim e mbështesin këtë. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Niazi Idrizi e ka kërkuar fjalën.

NIAZI IDRIZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është në një mendje me Komisionin Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, për mbështetjen në parim të këtij projektligji dhe si të tillë do ta votojë, duke rezervuar të drejtën që në proces të japë kontributin e vetë në pasurimin e këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike fjalën e ka deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar Projektligjin për prodhimin, grumbullimin dhe përpunimin si dhe tregtimin e duhanit dhe në parim do ta mbështesë këtë ligj, me disa vërejtje dhe në përgjithësi e sheh si shumë të nevojshëm, do të thotë, në parim aprovimin e këtij ligji.

Aktualisht në Republikën e Kosovës, do të thotë kontrabanda me tregtimin e duhanit do të vazhdon të jetë shqetësuese, me importimin e duhanit nga vendet e regjionit nga individë dhe grupe të caktuara të interesit, pa dokumentacion përkatës doganor, me falsifikime të banderolave.

Sipas nenit 23 të këtij ligji, kur bëhet fjalë për banderola, pika 2 thotë: “Vendosja pa autorizim apo falsifikim të banderolës konsiderohet vepër penale dhe sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi”

Neni 19, ku thuhet vendet për shitjet me pakicë, aktualisht shitja e duhanit nga të miturit dhe njëkohësisht për të miturit është evidente dhe jemi i vetmi vend në regjion që duhani shitet në rrugë, shitet para institucioneve të Republikës së Kosovës, nëpër lokale dhe aq më keq kjo shitje bëhet kryesisht nga të miturit, po nga fëmijët ditë e përditë po braktisin shkollën dhe po shndërrohen në duhanpirës.

Përpos që duhet të ndalohet dhe të sanksionohet ky paragraf duhet të futet tek dispozitat ndëshkuese që personi fizik apo juridik që detyron shitjen e duhanit përmes të miturve dhe njëkohësisht për të miturit, që me gjobë prej 1000 deri 3000 euro të gjobitet për kundërvajtje. Kështu është fjala tek dispozitat ndëshkuese tek paragrafi 3 se me gjobë prej 500 deri në 5000 euro për kundërvajtje dënohet subjekti fizik apo juridik nëse nuk është i regjistruar në regjistrin e duhanit të cilin e mban Ministria e Bujqësisë. Sipas nenit

12 të këtij ligji nëse nuk përmban etiketën dhe nëse produktet e duhanit prodhohen dhe tregtohen dhe që nuk posedojnë të dhënat për asgjësimin e markës tregtare. Kjo masë ndëshkuese ose gjobë e dënimit duhet të jetë jo 500 deri 5000, por të jetë 5000 deri në 10.000.

Edhe ne si grup do të thotë gjatë shqyrtimit të dytë do të shohim mundësinë e modifikimit dhe njëkohësisht do të japim kontributin tonë në kuadër të këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit “Vetëvendosjes”, nuk janë të përgatitur.

Në emër të AAK-së, Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qysh në fillim gjatë amendamentimit të këtij projektligji duhet të shikohet në përpikëri harmonizimi i amendamenteve sipas Ligjit të duhanit, në mënyrë që të mos sjellim paqartësi apo dykuptimësi për çështjen e njëjtë.

Neni 21 i projektligjit përmban dispozita që janë në kundërshtim me Ligjin për duhanin. Neni 9 i Ligjit të duhanit, ndalon çdo shitje të duhanit nëpërmjet makinave automatike, ndërsa neni 21 i këtij projektligji e lejon këtë.

Ndërsa projektligji ka edhe përzierje të ligjeve sa i përket reklamimit dhe promovimit të çdo forme të tregtimit të duhanit dhe produkteve të tij. Në këtë projektligji kjo dispozitë është e rregulluar me Ligjin për markat tregtare a në fakt kjo dispozitë është e rregulluar me Ligjin e duhanit.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe do ta përkrahë në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani, e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovën e Re ka shqyrtuar Projektligjin për: prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit. Duke marrë parasysh se projektligji është në lexim të parë, të gjitha sugjerimet, vërejtjet do t'i japim në Komision parlamentar dhe besoj që pas vërejtjeve të cilat do të amendamentohen në Komisionin parlamentar, projektligji do të marrë formën e duhur. Në parim e përkrahim projektligjin.

KRYETARI: Faleminderit!

SLS-ja nuk është.

Nga Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar “6+” pas shqyrtimit të Projektligjit për: prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit dhe pas arsytimit të rekomandimit nga ana e raportuesit, do ta mbështesë këtë projektligj në parim dhe kontributin e vet do ta japë përmes komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk të lajmëruar për diskutim nga ana e deputetëve. Kalojmë në procedurën e votimit.

Në sallë kemi 62 deputetë.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për: prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisione të përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Pasi kemi kuorumin e mjaftueshëm për votim kalojmë në pikën e tretë:

3. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 21 korrik 2011

Pyes, a ka vërejtje në këtë procesverbal? Nëse jo, atëherë konstatohet se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 21 korrik 2011.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të viktimave civile dhe të familjeve të tyre

Të nderuar deputetë,

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur më 26 korrik 2011, ka propozuar që shqyrtimi i parë i këtij projektligji të bëhet me procedurë të përshpejtuar, andaj para se të fillojmë me shqyrtimin, kërkoj deklarinimin e deputetëve me votim për shmangien nga Rregullorja e Kuvendit, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Për shmangie nga Rregullorja kërkohet miratimi me dy të tretat e votave të deputetëve të pranishëm në mbledhjen plenare.

Në sallë kemi 63 deputetë, për të kaluar procedura na duhen më së paku 41 vota. Kush është “për”? Faleminderit! “Kundër”? Shumica absolute është “për”, “kundër” nuk ka, as abstenim.

Konsideroj se Ligji i plotëson kushtet të fillojmë diskutimet, në parim.

Fjalën do t'ia jepja menjëherë kryetarit të Komisionit funksional për Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputetit Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Komisioni Për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional, e përkrah në parim miratimin e këtij projektligji. Projektligji ka ardhur në shqyrtim me procedurë të përsheptuar. Ne do të shqyrtojmë në komision sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe do të japim rekomandimet me qëllim për plotësimin e mëtejshëm të këtij projektligji dhe më pas të miratimit sa më të shpejtë të tij. Si kryetar i komisionit kërkoj përkrahjen e të gjithë deputetëve në këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit!

Radhën e kanë kryetarët e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuara familje të dëshmorëve, invalidëve të luftës, veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Që ta ndërtojmë të ardhmen, duhet ta respektojmë të kaluarën, që ta respektojmë të kaluarën, duhet të kemi vendosmëri dhe të bëjmë vepra konkrete. E njëra nga këto vepra është edhe shqyrtimi dhe miratimi i njërit nga projektligjet më të rëndësishme që ka shqyrtuar dhe miratuar ky Kuvend, siç është Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Grupi Parlamentar i PDK-së dhe mendoj se të gjithë ne sot ndihemi mirë që para vetes kemi këtë projektligj, i cili më në fund rregullon statusin e kategorisë më të respektuar të shoqërisë sonë. Ky hap ynë sot ka qenë dhe është i domosdoshëm. E dimë edhe ne që ky projektligj është dashur të miratohet edhe më herët, por falënderojmë të gjithë që kanë pasur mirëkuptimin në qasjen tonë të drejtë që të nxjerrim një ligj i cili është në përputhshmëri me kërkesat e shoqërisë sonë dhe mundësitë që ofron Kosova sot.

Ne jemi të vetëdijshëm se po miratojmë ligj, ligjin e së ardhmes, sepse po respektojmë e vlerësojmë të kaluarën tonë të përbashkët. Ne jemi të vetëdijshëm se për ushtrinë tonë ka nevojë edhe për ligje të tjera. E dimë se Kosova ka shumë etapa të rëndësishme që populli ynë i ka punuar dhe janë flijuar për çlirimin e vendit, por besoj shumë se në një të ardhme të afërt do të kemi para vetes edhe projektligje për këto kategori të shoqërisë.

Ne pa dyshim jemi dhe do të jemi gjithmonë mirënjohës për të gjithë brezat që punuan për çlirimin e vendit tonë e që puna e tyre kulmoi me sakrificën dhe luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Falënderojmë edhe një herë Qeverinë që na ka sjellë këtë projektligj, shoqatat e dala nga lufta që kontribuan për këtë ligj, i cili bën të ndihen mirë të gjithë ata që dhanë kontribut për çlirimin dhe pavarësimin e vendit tonë.

Ne si Grup Parlamentar mbështesim fuqishëm këtë projektligj dhe kërkojmë miratimin e tij. Gjithashtu, përkrahim vërejtjet dhe sugjerimet e organizatave të dala nga lufta dhe besojmë që këto vërejtje do të implementohen gjatë amendamentimit të këtij ligji gjatë punës në komisione.

Janë tri vërejtje thelbësore dhe do t'i përmend.

Vërejtja e parë, është në nenin 12, paragrafi 2 thuhet: “Të drejtat, beneficionet për veteranët e UÇK-së, si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen, realizimin e tyre, do të rregullohen me ligj të veçantë”. Te kjo duhet të ndryshohet dhe propozimi ynë është që të precizohen të drejtat dhe beneficionet e veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, edhe pse jemi të vetëdijshëm se ka implikime buxhetore. Prandaj, propozojmë që pjesa që ka të bëjë me beneficionet e veteranëve dhe pjesëtarëve, të fillojë se zbatuari pas verifikimit dhe kategorizimit të tyre dhe për këtë të caktohet një afat kohor, jo më shumë se 6 muaj nga data e miratimit të ligjit.

Gjithashtu, propozojmë që verifikimi nga ana e komisioneve përkatëse gjegjëse të bëhet edhe për invalidët dhe dëshmorët e UÇK-së.

Vërejtja e dytë është në nenin 3, paragrafi 1.6:”Dëshmor i Kombit është pjesëtari i UÇK-së që ka rënë në luftë për lirinë e vendit në vitet 1998 dhe 1999”. Ka vërejtje në kufizimin e periudhës kohore dhe ne propozojmë që për dëshmorët e UÇK-së, periudha kohore të jetë prej 30 dhjetorit 1991 e deri më 19 shtator 1999, kur është bërë demobilizimi i UÇK-së dhe në raste ku ndonjë veteran ka vdekur si pasojë e plagëve të marra gjatë luftës, të vlejë periudha 3 vjet pas luftës.

Dhe, vërejtja e tretë, ka të bëjë me nenin 3, paragrafi 1.5 për persona civilë të zhdukur. Ne kërkojmë që ky paragraf, i cili ka kundërthënie përbrenda tij, të hiqet komplet, pasi që është miratuar Ligji për personat e zhdukur dhe kjo duhet të harmonizohet, ky ligj me atë ligj për shkak se nuk mund të rregullohen në këtë ligj beneficionet, ndërsa në ligjin tjetër, kategorizimi të persona të zhdukur. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre ishte i mirëpritur nga qytetarët e Kosovës, e posaçërisht nga kategoritë e dala nga lufta. Kategoritë e dala nga lufta dhe anëtarët e familjeve të këtyre kategorive, me këtë projektligj gëzojnë të drejtën e pensioneve, beneficione sipas kategorizimeve dhe specifikave të ndryshme, siç janë: rehabilitimet mjekësore, shërbimet shëndetësore, riaftësimet profesionale, kompensimet

ortopedike, përparësitë në punësim, lirimi nga tatimi dhe doganat për vetura speciale dhe pajisje ortopedike, tarifat e liruara për harxhimet e energjisë elektrike: lirimi nga tatimi në pronë, stazhi i dyfishtë, përkujdesja për banim, përparësitë në arsimim, lirimi nga shpenzimet gjatë shkollimit në Universitetin publik, lirimin nga pagesat në trafikun publik dhe benificione të tjera.

Duke marrë parasysh edhe vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe opinionin e pavarur të Departamentit të Buxhetit nga Ministria e Financave, mendojmë se ky projektligj është solid dhe mund të avancohet me procedurat e mëtutjeshme. Por, fatkeqësisht, ky projektligj përkundër premtimeve nga autoritetet e Qeverisë, nuk e trajton çështjen e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nga ana e të cilëve edhe është insistuar për nxjerrjen sa më të shpejtë të Ligjit për veteranët, të cilët e ndërprejnë grevën dhe anuluan protestat duke u bazuar në premtimin e dhënë nga ana e Qeverisë.

Nga gjithsej 27 nene, vetëm neni 12, në 2 paragrafë e rregullon tërë problematikën e veteranëve, ku thuhet, citoj:

“1. Sipas dispozitave të këtij ligji nga organi përgjegjës i Qeverisë, njihet dhe përcaktohet statusi i veteranëve të UÇK-së.”

”2. Të drejtat me benificione për veteranët e UÇK-së, si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre, do të rregullohen me ligj të veçantë.”

Pas këtyre konstatimeve, ekzistojnë vetëm dy mundësi:

E para, nga emërtimi i projektligjit të hiqet termi veteranët e UÇK-së, pasi që në këtë ligj nuk bëhet fjalë për trajtimin dhe benificionet e veteranëve.

Dhe, nën dy, me nene shtesë, me seriozitetin më të madh edhe veteranët të trajtohen ashtu siç u takon dhe është premtuar nga autoritetet e Qeverisë.

Çështja e radhës me rëndësi është gjithë përfshirja apo mos përjashtimi. Më konkretisht, me nenin 3, paragrafi 1.9, ku thuhet se: “Veteran i UÇK-së është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj, i cili është radhitur në radhët e UÇK-së dhe është regjistruar si ushtar nga komandat apo shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, brenda periudhës 30.12. 1991 deri më 12.6.1999.” Janë të përjashtuar veteranët të cilët shërbyen në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, por nuk u regjistruan në shtabet, komandat e zonave apo në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, sepse ata ishin të mobilizuar dhe të udhëhequr nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, nën komandën e kolonelit Ahmet Krasniqi.

Të nderuar deputetë,

Ne sot mund të arrijmë një unitet, i cili fatkeqësisht ishte i brishtë gjatë luftës. Për këtë unitet në lidhje me vlerat e luftës duhet një vullnet i mirë i Qeverisë që me rishikimin e ngjarjeve gjatë luftës, edhe pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nën organizimin e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, të trajtohen me të njëjtin ligj. Kjo çështje sot është shumë më lehtë të trajtohet, pasi që në kreun e Qeverisë gjenden

kryeministri zoti Thaçi, dhe ish kryeministri i Qeverisë në ekzil, zoti Bukoshi, si protagonistë të shumë proceseve dhe zhvillimeve në rrafshin politik- ushtarak në vitet 1998 e 1999.

Konkretisht, propozoj dhe insistoq që në kuadër të Komisionit për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, veteranit, pjesëtarit të UÇK-së apo të internuarit të UÇK-së, krahas përfaqësuesve të Zyrës së Kryeministrit, Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, zonave operative të UÇK-së, Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, Shoqatës së Invalidëve të Luftës, ish- TMK-së, t'i bashkëngjiten edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilët do të ofrojnë të dhëna të azhuruara për të gjitha kategoritë e lartpërmendura të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Me një qasje të tillë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës është i gatshëm të votojë pro dhe me politika dhe ekspertizën e saj të kontribuojë në trajtimin me ligj për të gjitha vlerat dhe kategoritë e dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të flas për qëndrimin tonë dhe për përmbajtjen e Projektligjit, i quajtur: “Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të dëshmorëve”, më lejoni t’ju shpjegoj sot pse deputetët e lëvizjes “Vetëvendosje” mungojnë në këtë seance.

Deputetët e lëvizjes “Vetëvendosjes” konsiderojnë që gjendja në Kosovë është e jashtëzakonshme dhe ajo duhet të shpallet si e tillë edhe nga Presidentja, edhe nga institucionet e Kosovës dhe nuk bën të aktrojmë normalitet. Për këtë arsye, ata sot nuk janë prezentë në këtë seancë. Ne jemi të gatshëm dhe mund të punojmë si Parlament në përgjithësi dhe si deputetë të lëvizjes “Vetëvendosje” edhe të shtunën, edhe të dielën, edhe të hënën, edhe të martën, edhe gjatë gjithë gushtit, por dita e sotme do të duhej të ishte ditë vetëm e seancës së jashtëzakonshme në përputhje me shqetësimin dhe zemërimin që kanë qytetarët e Kosovës ndaj gjendjes së krijuar në veri. Por, sidoqoftë, unë jam sot këtu edhe një herë të shpreh edhe solidaritetin e vazhdueshëm ndaj gjithë veteranëve, bashkëluftëtarëve të mi të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët për 12 vjet me radhë kërkojnë të drejtat e tyre që do të duhej t’u takonin qysh në ditën e parë të lirisë, deri te shprehja e protestës së tyre dhe reagimit të tyre përmes grevës dhe solidaritetin me grevistët, të cilët për 61 ditë kërkuan ligj për të drejtat e veteranëve.

Pra, greva nuk ishte vetëm kërkesë për një ligj, por ishte kërkesë për një ligj të drejtë, i cili do të përfshinte shqetësimet e të gjithë veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në ndërkohë, ne kemi po ashtu edhe dy letra drejtuar të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, njëra nga ato u përmend nga një parafolësit e mi dhe tash nuk dua ta përsëris, që ka të bëjë me nenin 12, paragrafi 2, që ka të bëjë me nenin 3, paragrafi 1.6 dhe me nenin 3, paragrafi 1.15, shqetësime dhe kërkesa të tyre shumë të drejta të cilat do të duhej të përfshiheshin në Ligjin për statusin e veteranëve dhe të drejtat e tyre. Por, sidoqoftë, po ashtu kemi edhe një letër tjetër drejtuar deputetëve, në këtë rast deputetëve të lëvizjes “Vetëvendosje”, nga Këshilli grevist, me të cilën negocoi Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës dhe si rezultat i negociatave sot ka ardhur Projektligji për veteranët e luftës në Kuvend, e të cilët po ashtu kërkojnë benificione, kërkojnë pensionin që t’u takojë të gjithë veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe po ashtu ata kërkojnë që të përfshihet në cilën do ligj për ta, një fond i posaçëm shëndetësor për invalidët dhe veteranët, sepse jo të gjithë veteranët janë gjithmonë të shëndoshë dhe jo të gjithë veteranët dhe familjet e tyre kanë mundësi shërimi kur ata kanë nevojë për shërim.

Por, t’i kthehem pak a shumë trajtimit të projektligjit në disa pika të tij. Duke filluar që nga titulli i këtij projektligji, ne japim vërejtjet tona esenciale dhe mendojmë që ose është gabuar ose është bërë gabim ose është gabuar qëllimisht, sepse këtu na ka ardhur një projektligj, citoj: “Për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve”, mendoj që nuk është i drejtë ky formulim i fjalisë “ të drejtat e dëshmorëve”, sepse dëshmorët nuk kërkojnë të drejta tashmë, kërkojnë familjet e tyre, pastaj invalidëve, duhet cekur cilët invalidë, kush janë këta invalidë, sepse këtu nuk përmendet mbiemri i kujt invalid bëhet fjalë, veteranëve, po ashtu nuk përmendet, me një presje ndahet fjalia e veteranëve me pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që nënkupton në fjali, formulimi i fjalisë kupton që pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë njëra nga kategoritë të cilat trajtohen në këtë ligj, duke vazhduar pastaj me viktimat civile dhe familjet e tyre.

Pra, qysh në titull është bërë gabim, sepse tek e fundit ky nuk është projektligji që e kërkojnë veteranet, që e duan veteranet, por mbi të gjitha që ia shohin hairin veteranët, hair të cilin e kanë paguar me luftën e tyre. Në anën tjetër, mendojmë që Ministria e Mbrojtjes do të ishte Ministria më adekuate dhe më dinjitoze që do të merrej me veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe jo Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Por, sidoqoftë, ne do të vazhdojmë të japim edhe vërejtjet tona tjera të cilat në përfundim do të sjellin që vërtet ky ligj nuk është ai të cilën e kërkojnë dhe kanë nevojë veteranët, ky ligj është të cilët kanë nevojë të jetë, por këtë ligj nuk e kanë kërkuar veteranët.

Duke iu referuar nenit 3.1.6 ashtu siç u tha edhe më herët, kur thuhet: “Dëshmor i kombit është pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ka rënë në luftë për lirinë e vendit në vitet 1998 dhe vitin 1999”. Edhe formulimi edhe qëllimi i kësaj pike është gabim, sepse dëshmorë të kombit do të duhej të ishin jo vetëm ata luftëtarë të cilët kanë rënë vetëm në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e aq më tepër vetëm në vitin 1998 – 1999, por dëshmorë të kombit janë të gjithë ata pjesëtarë të kombit, ata kombas tanë të cilët kanë rënë për kauzën kombëtare. Pra, formulimi, qysh në formulim është gabim dhe, në anën tjetër, nuk mund të thuhet nëse konsistohet ose nëse mendohet që dëshmor i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në këtë rast e shkruar “dëshmor i kombit” janë vetëm dëshmorët të cilët kanë rënë në vitin 1989 – 1999. Një ndarje dhe një përjashtim i dëshmorëve të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët pa dashjen e tyre kanë rënë pra kësaj date, duke përfshirë emra të mëdhenj themelues të ushtrisë Çlirimtare të Kosovës siç janë: Zahir Pajaziti, Luan Haradinaj, Adrian Krasniqi, Edmond Hoxha, Mehë Uka edhe shumë e shumë të tjerë të cilët sot s'po i përmendi këtu, nuk guxon asnjëherë t'u mohohet e drejta që në këtë rast jo vetëm të mos jenë dëshmorë të kombit, por e drejta që të mos jenë dëshmorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dëshmorë të kombit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo formulimi më i mirë do të ishte" dëshmorët e kombit të rënë në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". Po ashtu, vlen edhe për invalidët dhe kategoritë e tjera.

Pika ndër më të ndjeshmet e trajtimit të gjithë kësaj teme nga veteranët dhe për veteranët, ka qenë edhe statusi i veteranit. Pra, kush është veteran i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kush është veteran i Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës? E theksova - i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, jo pa qëllim.

Pra, në nenin 3, po ashtu, të njëjtin nen pika 1.9, thuhet se, citoj: "Veteran i UÇK-së është qytetari i Kosovës dhe shtetasi i huaj, i cili është radhitur në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe është regjistruar si ushtar, theksoj është regjistruar si ushtar nga komandat, shtabet e zonave operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së brenda periudhës 30.12.1991 deri në periudhën 12.6.1999" Këtu nuk kemi ndonjë vërejtje për kohën e përfshirjes së gjithë kësaj, në përputhje edhe me ligjet paraprake që është bërë këtu, por ne kemi vërejtje se jo të gjithë njerëzit e regjistruar mund të jenë edhe veteranë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sepse ne e dimë nga përvoja jonë se janë regjistruar shumë në pikat e regrutimit jashtë Kosovës, qoftë në vendet tjera, qoftë edhe në Komandën e Regrutimit në Durrës dhe në komandat e tjera të regrutimit kudo, sidomos nëpër Shqipëri, janë regjistruar si pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me dashjen apo pa dashjen e tyre nuk ia kanë arritur që të përfshihen në luftë, që të përfshihen atje ku janë nisur.

Pra, ne mendojmë që veteran i një lufte, në këtë rast veteran i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duhet të jenë të gjithë ata luftëtarë, ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesëmarrës në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkatësisht të përfshirë në zonën e luftës që ka qenë gjithë Kosova dhe të përfshihet në kohën e luftës ku ka qenë lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pra, veteranë të luftës duhet të jenë ata të cilët kanë marrë pjesë në luftë, pa e mohuar asnjë kontribut të atyre që nuk e kanë arritur dhe pa e mohuar asnjë kontribut të atyre që kanë sakrifikuar shumë që të arrijnë deri në strukturat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat për momentin atëherë nuk kanë qenë të përfshirë në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Më lejoni t'ju marrë vetëm një krahasim të vogël. Jo të gjithë ushtarët e ushtrisë amerikane sot janë veteranët e luftës, qoftë të Vietnamit, qoftë të Irakut, qoftë të Afganistanit, por veteranë të luftës së ushtrisë amerikane sot janë veteranët të cilët kanë marrë pjesë në luftë dhe veteranë të luftës nuk janë ata të cilët në të njëjtën kohë janë ushtarë duke shërbyer në vende tjera paqe apo në Shtete të Bashkuara të Amerikës.

Me qëllim e mora këtë rast për ta ilustruar faktin tonë se të mobilizuar në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe rreth kësaj i kanë përgjigjur shumë më shumë, dhjetëra njerëz

të cilët kanë dashur ta mobilizojnë vetveten e tyre, ta mobilizojnë kohën e tyre në Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo në Luftën e Kosovës, por e theksoj edhe një herë, veteranë të luftës nuk mund të jenë ata të cilët nuk kanë qenë të përfshirë në zonën e luftës dhe në kohën e luftës, në të dyja bashkë.

Këtyre vërejtje edhe vërejtjeve të tjera, të cilat janë shumë evidente, ne do të vazhdojmë t'ju qëndrojmë prapa derisa ne të bindemi që ne po nxjerrim një ligj për veteranët e Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për njohjen e të drejtës së tyre dhe statusit të tyre dhe po ashtu edhe për njohjen e beneficioneve dhe përfitimin e tyre që ata duhet ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni fjalën!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Më ndjeni për kohën, ndoshta pak a shumë të tepruar, por megjithatë po flas në emër të grupit parlamentar.

Pra, po ashtu, në nenin 17 këtu përcaktohet edhe roli i Zyrës për Çështjen e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mekanizmat tjerë, unë mendoj që këto zyra kur të themelohen, duhet të jenë funksionale.

Sidoqoftë, për të mos u marrë shumë kohë, e vetmja gjë, e vetmja pikë që në këtë ligj duhet të respektohet shumë dhe do të ishte ndoshta edhe një pikë e veçantë e seancës, pse jo edhe një seancë, do të ishte pika e katërt, ku thuhet kur komandanti legjendar parashihet dhe i bëhet, siç thuhet, krahas komandantit legjendar Adem Jashari, i cili është komandant legjendar Adem Jashari dhe këtu parashihet që të ligjërohet titulli - komandant legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra krahas komandantit legjendar Adem Jashari, për sakrificën dhe kontributin për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, familjes Jashari nga Prekazi i komunës së Skenderaj, i njihet statusi i veçantë, ku përveç të drejtave dhe beneficioneve të përcaktuara me këtë ligj, i njihen edhe të drejtat dhe beneficionet tjera të cilat përcaktohet me akt nënligjor të veçantë të nxjerrë nga Qeveria.

Por, të kthehemi te esenca. Njëra nga shqetësimet e veteranëve, të gjithë veteranëve të përfshirë, edhe Organizatën e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës edhe organizime tjera të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfshirë këtu edhe Këshillin grevist, është që nenin 1.3 pika 2, ku thuhet: “ Të drejtat dhe beneficionet për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre do të rregullohen me ligj të veçantë” Ne këtë ligjin e veçantë e kemi kërkuar sot që të jetë këtu. Pra, ne kemi kërkuar një ligj, i cili njeh të drejtat, beneficionet për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre, të drejtën që u takon atyre. Pra, ne kemi kërkuar këtë që ky projektligj parasheh që të rregullohet me një ligj të veçantë. Ai ligj i veçantë do të duhej sot të ishte këtu që ne ta trajtonim. Pra, përderisa ne e dimë, përderisa ne të na thuhet që ajo që ju po kërkon do të rregullohet me një ligj të

veçantë, ne po e presim këtë “projektligjin e veçantë “ që ta bëjmë një ligj të veçantë i cili do t’i njehë të drejtat dhe benificionet e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Për në fund, më lejoni vetëm te një përkufizim të fokusohem, duke përkufizuar te çështja e familjes së ngushtë, çështja e termit “anëtar i familjes së ngushtë” mendoj që duhet ta keni parasysh, nuk duhet të thuhet “anëtar i ngushtë i familjes, po “anëtar i familjes së ngushtë”

Pra, ne duhet ta kemi parasysh se edhe përkufizimi në këtë rast ka shumë rëndësi dhe ka shumë implikime në ligj. Si të tillë, ne sot e konsiderojmë që ligjin të cilin kanë nevojë veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ligjin të cilin e kanë negociuar Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës me veteranët, ligji për të cilët kanë nevojë gjithë veteranët e Kosovës, në veçanti veteranët dhe organizatat e tyre, sot nuk e kemi në duar, sot e kërkojmë Ligjin për veteranë dhe njohjen e të drejtave të tyre, jo që brenda një ligji tjetër të përcaktohet që duhet ta rregullojmë me një ligj të veçantë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Urdhëro, kryeministër e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

E kemi sjell para jush Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Ky ligj nuk është i negociuar, ky ligj është sjell nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ky ligj ka qenë i sjell edhe një vit më herët po në Kuvend dhe pastaj pas zhvillimeve politike ka ndodhur që të rikthehet përsëri në Qeveri e pastaj përsëri të riprocedohet për në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pra, kjo është përgjegjësia shtetërore që po tregon Qeveria e Republikës së Kosovës dhe në asnjë rrethanë ndonjë improvizim.

Ky projektligj është i miratuar nga Qeveria më datën 22.7.2011. Ky projektligj është një akt ligjor i rëndësisë së veçantë, sepse rregullon dhe përcakton statusin e dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, invalidëve të UÇK-së, invalidëve civilë, viktimave civile të luftës dhe kategorive të tjera të dala nga Lufta Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare përmes pensioneve dhe benificioneve të veçanta për kategoritë e dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë vendimtarë për lirinë dhe çlirimin e vendimit.

Duke marrë parasysh këtë tashmë ky projektligj ka marrë emrin në masë si Ligji për vlerat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Përmes dispozitave të këtij projektligji për kategoritë e trajtuara në këtë projektligj sigurohen këto pensione: pensioni familjar të cilin e realizon familja e ngushtë e dëshmorit e të zhdukurit e të pagjeturit të UÇK-së, e viktimës civile të luftës si dhe familjet e të zhdukurit civil, pensioni invalidor personal, të cilin e realizon invalidi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe invalidi civil i luftës në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj, pensioni invalidor familjar të cilin e realizon familja e ngushtë pas vdekjes së invalidit, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj, si dhe rritja e pensioneve për kategoritë e trajtuara në projektligj, do të bëhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, varësisht nga mundësitë buxhetore, shpenzimet e shportës jetësore dhe inflacioni eventual.

Në kuadër të projektligjit është bashkangjitur edhe një shtojcë e veçantë për lartësinë e pensioneve aktuale të kategorive që trajtohen në projektligj, e cila do të shërbejë si bazë për të ardhmen.

Përveç pensioneve, kategoritë e trajtuara në këtë projektligj janë përfitues edhe të beneficioneve të caktuara që konsistojnë në shtesa për përkujdesje dhe ndihmë nga personi: rehabilitimi mjekësor dhe fizikal, shërbime shëndetësore primare, sekondare dhe terciare, shërbime shëndetësore jashtë vendit, riaftësimi profesional, kompensimi ortopedik, përparësi në punësim në ndërmarrjet e sektorit publik dhe privat, lehtësime tatimore dhe doganore, tarifa e lirë dhe e reduktuar të energjisë elektrike, stazhi i dyfishtë i periudhës së luftës, përparësia e regjistrimit në institucionet arsimore në kushtet e barabarta, lirimi nga pagesat administrative në shkollim universitar publik e të tjera.

Po ashtu me këtë projektligj përcaktohet baza ligjore për themelimin e një komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të gjitha kategorive të trajtuara me këtë projektligj, që do të përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve kompetente për këtë çështje, Zyrës për çështje të veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila do të jetë një organ qeveritar për bashkërendim dhe koordinim të aktiviteteve për kategoritë e dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të trajtuar në këtë projektligj.

Gjithashtu, është me interes të theksohet fakti se në shqyrtimin dhe hartimin e këtij projektligji, përveç zyrtarëve qeveritarë, kanë marrë pjesë edhe përfaqësues e grupeve të caktuara të interesit siç janë: Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve, Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe grupet tjera të interesit. Unë i falënderoj për kontributin e tyre, natyrisht se gjithmonë angazhimet e tyre kanë qenë që të ketë një angazhim edhe më afirmativ, por kjo është përgjegjësia e institucioneve dhe e Qeverisë, aktualisht. Po ashtu është shumë i rëndësishëm edhe fakti se ky akt ligjor është në përputhje me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, ICO-n dhe organizatave tjera ndërkombëtare.

Kam nderin që pata rastin t'ju informoj në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen në këtë projektligj të vihen në suazat e kornizës ligjore adekuate për të herë të parë në shtetin e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Dua të bëjë një sqarim. Ka ndodhur një lëshim teknik, vlerësohen të gjithë të rënë nga viti 1945 e tutje deri në ditët tona, të rënë për liri dhe pavarësi. Në atë kohë nuk ka pasur UÇK, por ka pasur lëvizje kombëtare për liri, pavarësi dhe rend demokratik. Pra nga viti 45 deri në përmbyllje të luftës, dhe ju kërkoj ndjesë për këtë lëshim teknik.

Dy, e dëgjova me vëmendje deputetin Çuni, janë shumë të mirëpritura rekomandimet që do t'i sillni.

Tre, ky projektligj është projektligj që duhet të sjellë unitet jo për hir të angazhimeve të caktuara politike apo pretendimit të politizimit të këtij projektligji të mbeten peng veteranët e luftës, invalidët, familjet e dëshmorëve. Ne kemi rritur pagat e tyre të familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve për 50% në këtë vit, por në të njëjtën kohë duhet të ketë një verifikim shumë, shumë profesional.

Të nderuar deputetë dhe qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Unë dua të jem shumë i sqartë para jush për mundësitë dhe kapacitetet që kemi si shtet i Kosovës, si buxhet i Kosovës, por edhe për përgjegjësitë që kemi. Për mua gjithë njerëzit e rritur apo një moshe të caktuar janë veteranë të luftës në Kosovë. Gjithë kemi dalë prej lufte dhe gjithë janë çlirimtarë kudo që kanë kontribuar dhe fatkeqësia më e madhe e jona do të ishte nëse pretendojmë t'i ndajmë njerëzit në çlirimtarë dhe joçlirimtarë, në liridashës dhe joliridashës, në kontribues dhe jokontribues, në ndihmues dhe mohues. Ky është ligj që duhet sqaruar të na unifikoj përsëri. Çdo njeri që ka kontribuar për liri ka qenë ushtar i lirisë ka qenë çlirimtar dhe ai kontribut duhet t'i njihet, respektohet, jo vetëm në aspektin moral, por edhe institucional e shtetëror. Askush nuk mund të mohojë rezistencën 1945-1990 të lëvizjeve ilegale. Në asnjë rrethanë ku nuk do të kishte as demonstrata të vitit 1968 për kërkesën “ Kosova Republikë” pa lëvizjen e mëhershme të udhëhequr nga simboli i rezistencës kombëtare Adem Demaçi. Kurrë nuk do të ndodhte '81-ja pa '68-ën, por edhe kurrë nuk do të ndodhte ai ndryshim në 90-tën pa angazhimet '81-90. Askush nuk mund të mohojë rezistencën dhe padëgjueshmërinë qytetare dhe civile 1990-1998. dhe kulminacionin i rezistencës për liri të plotë nga Serbia me Luftën e UÇK-së dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Prandaj, unë ftoj që ky projektligj të shikohet nga prizmi profesional dhe i përgjegjesisë së lartë shtetërore dhe jo i animeve politike. Unë vlerësoj se secili duhet të japë kontributin e vet për të ofruar dhe lëshimet që kanë ndodhur në të kaluarën, thjesht ky projektligj t'i tejkalojë, ofrojë dhe të bëjë kohezionin e plotë edhe politik edhe qytetarë edhe shtetëror.

Veteranët e luftës, dëshiroj të theksoj se si Qeveri tash duhet të jemi shumë të hapur. I kemi dy lista, njërin listë e kemi me 40.000 veta, njërin e kemi me 20.000 veta. Duhet të ketë qartësim nga nivelet profesionale, të nderuar deputetë, që të planifikohet buxheti për 40.000 veteranë apo për 20 mijë veteranë. Unë thashë për mua krejt njerëzit e moshuar të Kosovës janë veteranë të luftës dhe janë çlirimtar, por janë edhe specifikat

që i përcaktojnë qartë aspektet legale dhe juridike të qenurit veteran. Pra, na duhet kohë dhe na duhet punë e përbashkët e të gjithë neve.

Invalidë të luftës, të nderuar deputetë, të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, pa asnjë keqkuptim 1300 invalidë të luftës, të lutem jo, jo nuk janë komisionet qeveritare, janë jashtë qeveritare. Ky është buxheti jonë, këta janë bashkëluftëtarë të mi, dhe të juaj, të gjithëve, por ky është buxheti jonë, kah u rriten 1300? Kjo kërkon përgjegjësi të përbashkët të gjithë neve, prandaj unë kërkoj ndihmën tuaj të përbashkët edhe për çështjet që i ngriti deputeti Quni, gjithashtu edhe për çështjet që tash drejtpërdrejt dhe në mënyrë shumë publike i ngrita para jush. Ne nuk kemi buxhet t'i mbulojmë ashtu siç pretendojmë ne me vullnet të lirë. Secili sot i gjen tri nënshkrime dhe dëshmon se ka marrë pjesë në një betejë, i gjen tre kolegë, thjeshtë, kështu ka shkuar deri me tani, sidomos në aspektin e veteranëve, se prej invalidëve, familje të dëshmorëve është më e qartë, por është shqetësuese rritja e numrit të invalidëve për një vit, 1300, ndoshta nuk janë paraqitur deri në atë kohë dhe unë dua të besoj se kështu është. Por, për gjithçka duhet të kemi vlerësimin më të lartë profesional shtetëror, pastaj të planifikojmë edhe buxhetin. Por, ky ligj duhet të nxirret, e kemi sjellë vitin e kaluar, ka shkuar nëpër procedura, mund të them lirisht të mërzitshme, burokratike, harmonizimit të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, ICO dhe të gjitha organizmat tjerë ndërkombëtarë, por është momenti i fundit që të kalojë në leximin e parë dhe gjatë kësaj periudhës kohore, t'i harmonizojnë të gjitha qëndrimet dhe pastaj të marrë përgjegjësi të plotë edhe të mbulesës financiare me qartësimin dhe identifikimin e saktë të numrit të veteranëve të luftës, të invalidëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve.

Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Deputetë, në prezantim të ligjit nuk ka replikë. Ju lutem! Jo, jo prezantim i ligjit ishte, nuk ishin me kohë. Erdhën pas kohe, prezantim i ligjit ishte, dhe në prezantim të ligjit nuk ka replikë. Vazhdojmë. Mund ta merrni fjalën dikush nga deputetët e radhës.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Para vetes kemi Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Titulli më së pari nuk është në rregull, për arsye se as nuk specifikon këto kategori që u përmendën në mënyrën më të mirë, por...

(Debat ne sallë)

AHMET ISUFI: ... Përveç mos saktësisë në titull, ne kemi edhe kategori tjera brenda këtij ligji të cilat ose duhet të hiqen nga ky ligj siç është kategoria që quhet: e të zhdukurve, që u përmend edhe nga një vërejtje që është bërë nga shoqatat e dala nga lufta ose duhet të specifikohet në mënyrë të saktë.

Kryeministri theksoi se veteranë, invalidë, dëshmorë të kombit janë të gjithë ata që mund të kategorizohen prej 1945, nëse është ashtu, nuk është momenti këtu për propagandë, ne jemi kah flasim për materie në këtë ligj. Dhe, nëse është fjala për këtë ligj, atëherë duhet t'i bazohemi këtij ligji, të futen të gjitha kategoritë. Edhe unë pajtohem nga 1945-ta, por që të jenë të kategorizuara dhe në titull të jenë të definuara gjërat. Së pari obligim është që titulli të jetë i saktë ashtu si duhet.

Tjetër element është që dëshmorët e kombit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk e kanë datën e saktë. Ne e dimë, jemi dëshmitarë të kësaj lufte dhe i dimë periudhat kur ka filluar lufta e UÇK-së, ndërsa në ligj ne e kemi nga viti 1998, që harrohen shumë figurat të cilat në fakt janë themeluese të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Po ashtu, konsiderojmë se shumë elemente të cilat janë të futura në këtë ligj, konsiderohen si elemente të cilat duhet zbatuar. Ndërsa, po të llogaritet kostoja, atëherë duhet të qitet shuma precize, sepse ligji i detyron dhe ne e kemi për obligim që ligjin ta zbatojmë dhe nesër të mos biem në kundërshtim dhe të mos mund t'i përmbushim nevojat ndaj qytetarëve tanë.

Njëkohësisht, statusi i veteranëve i cili përmendet këtu, nuk bart edhe obligimet financiare dhe të drejtat e veteranëve të cilët duhet t'i gëzojnë veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këtu kemi të bëjmë vetëm me një status. Sa për çështje morale, ju faleminderit na krejt populli e ka falënderimin për luftën tonë, për lëvizjet tona çlirimtare, për periudhat që kanë rënë njerëzit dhe kanë dhënë kontribut, por megjithatë ne po flasim për ligjin dhe nëse bazohemi në ligj, atëherë duhet të saktësohen elementet.

Unë për të mos iu marrë më shumë kohë, do të mundohem që në përgatitje për leximi ne dytë me amendamente ta përmbushim, por megjithatë kish kërkuar edhe një herë. Nuk është mirë, as propagandë të bëhet, as të mashtrohem, por të jetë një ligj, i cili në fakt bazohet në nxjerrjen e statusit të drejtës të gjitha kategorive dhe pa ashtu edhe të gjitha ato kërkesa të realizohen në baza ligjore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Unë po e bëj një kërkesë që realisht, ne në parim duhet ta miratojmë Ligjin. Për ndryshime substanciale, mendoj që është puna që do ta bëjë komisioni dhe të gjithë ata që janë të interesuar, të japin kontributin e tyre në ndryshimin kualitativ të këtij projektligji, i cili duhet të bëhet ligj.

Fjalën ia kisha dhënë Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re. Kush e ka kërkuar fjalën prej juve? Deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Ju faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së, të Ushtrisë Çlirimtarëve të Kosovës, të viktimave civile dhe të familjeve të tyre.

Unë, meqë jam kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione dhe Persona të Zhdukur, e ndiej obligim që të bëj një sqarim, sepse u përmend këtu që nuk janë përfshirë personat e zhdukur. Personat e zhdukur janë përfshirë në këtë projektligj, si përkufizim dhe benificionet e tyre, gjithashtu janë për përfshirë.

Më herët një parafolës tha se benificionet duhet të hiqen, sepse janë të përfshira në Projektligjin për të zhdukurit, benificionet nuk janë të përfshira në Projektligjin për të zhdukurit, për këtë arsye edhe janë përfshirë këtu dhe kishte për të qenë gabim i madh sikur të mos ju njihen familjarëve benificionet.

Pastaj kemi një shkresë nga organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së. Mendoj se duhet të kihet parasysh, të merret parasysh, mirëpo neni 3, paragrafi 1.15, ata propozojnë të hiqet, çka unë mendoj se do të thotë janë bazuar në një fakt që në të vërtetë nuk është, nuk ekziston më mirë të themi është i gabueshëm, sepse propozojmë të hiqet ky nen, se thonë që Ligji për personat e zhdukur është miratuar. Nuk është miratuar Ligji për personat e zhdukur do të miratohet në shtator.

Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk është askush.

Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, kush e do fjalën? Deputeti Enis Krvan

ENIS KRVAN: Ju faleminderit, kryetar!

Kosova Kurtuluş Ordusu savaşıları, malülleri, gazileri, ordu mensupları ve onların ailelerinin konumuna ilişkin Yasa tasarısını özenle inceledik. İnsani açıdan Yasa ile kapsanmış olan bireyler ve ailelerin savaş acılarını yaşadıklarını biliyoruz. Mevcut bütçeye rağmen toplum, daha doğrusu devlet hiç olmasa finans yardımını sunarak bu kişilerin acılarına ortak olduğunu gösterebilir. Devlet ailelere sevdiklerini geri çeviremez, savaş malülerine sağlıklarını geri veremez, ancak devletin onları önemseyişini ve yaşadıklarını, yaşamakta oldukları kayıp ve acılarını paylaştıklarını gösterebilir. Ayrıca bütçe Dairesi de real ve ciddi değerlendirmelerde bulunmuşken, Uluslararası Para Fonu (İMF) önergeleri de göz önünde bulundurulmuştur.

Dolayısıyla ilk okunuşunu kabul etmekteyiz.

Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Me kryetarët e grupeve përfunduar. Ju njoftoj se janë të lajmëruar 11 deputetë. Ju kisha kërkuar që të na kurseni kohën sa të mundeni!
Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Normalisht që do të përpiqem që mos të marrë kohë, megjithatë janë dy çështje se mendoj që në këtë fazë, po, janë për leximin e parë dhe aprovimin, ta them menjëherë në fillim dhe pikërisht sot, të këtij ligji, dhe mendoj se nuk është koha të t'hollojmë shumë, sepse është një ligj të cilin po e presim në këtë lexim të serishëm që dy muaj. Ju po thoni se nuk ka, edhe me presione të jashtme, edhe të brendshme dhe kjo duhet të thuhet haptas. Prandaj, nuk ka kurrfarë arsye në sot të presim perfeksion dhe mos ta votojmë. Unë jam ta votojmë dhe duhet të them që ka histori ky ligj, nuk është për herë të parë, kjo është materie për të cilën tri legjislacione të këtij Kuvendi kanë biseduar dhe ju e keni në krye të këtij ligji, që pos nenit të Kushtetutës, thotë: Duke pasur parasysh Rezolutën e Kuvendit të Kosovës dhe 15.05. 2003, për Luftën Çlirimtare të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi.

Keni kujdes, është bërë debat i hollë për të gjitha temat që u përsëritën edhe nga kryeministri, edhe nga diskutuesit të tjerë për definime dhe redefinime dhe ju e dini, deputetë të vjetër, qysh ka ardhur kjo rezolutë, që pak a shumë ka qenë hyrja në trajtimin e kësaj materie.

Për mos me shkuar tutje, ju keni dhënë fund ligjit, çfarë aktesh zhvlerësohen me këtë ligj, domethënë, ka një pjesë rregullative ligjore e këtij vendi, e cila rregullon materiet e këtyre kategorive dhe njerëzit paguhën dhe ju e dini se pa ligj nuk paguhën.

Ajo që unë dua të them posaçërisht këtu, është edhe një definim. Te neni 3.1.6, dhe gjithnjë te përkufizimet dhe gjithnjë në frymën e Rezolutë së 15 majit 2003, që është mirë ta shikojnë njerëzit, nëse nuk e kanë se çka shkruan atje, çka do të thotë luftë çlirimtare e popullit të Kosovës për liri e pavarësi, që është përtej UÇK-së, keni kujdes, është e zgjeruar. Në bazë të kësaj, neni 3.1.6, mendoj se duhet të duket kështu: “Dëshmor i kombit është pjesëtari i UÇK-së dhe personi që ka ra në luftën për liri dhe pavarësi të Kosovës”. Është edhe në frymën e këtij ligji, është edhe në frymën e rezolutës, në të cilën mbështetet ky ligj dhe merr dhe kategoritë përtej asaj që quhet viti '91 ose vit '98, që në princip pajtohem të gjithë.

Dhe, e dyta, te 3.1.9, te Veteran i UÇK-së, meqë nëse nuk është precizisht me kohë, nuk thotë për UÇK-në '91 diçka precizisht, që unë e di me dokumente, derisa i di unë, nuk thotë, pikërisht '91 dhe '99 dhe Veteran i UÇK-së merret edhe njeriu që shkon përtej asaj që quhet aktivitet i strukturuar dhe efektiv i UÇK-së, atëherë dhe këtu veterani i UÇK-së, meqë UÇK është si cilësim, jo si karakterizim, mund të formulohet pak më gjerë, unë nuk po jap formulimin. Ju faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Agim Kuleta e ka fjalën. Agim, i rrumbullako fjalët sa të mundesh!

AGIM KULETA, Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe unë e kam një vërejtje të cilën nuk mund të rri pa e thënë, pasi konsideroj është substanciale edhe ka të bëjë pikërisht me titullin e ligjit. Ne konsiderojmë se këtu është bërë një gabim, jo vetëm në kuptimin terminologjik, por fjala është edhe për një padrejtësi në kuptimin përmbajtjesor. Po fals në emër të Lëvizjes për Bashkim, në këtë rast. Thuhet se Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne konsiderojmë që nuk është në rregull të thuhet veteran i ushtrisë ose invalid i ushtrisë, nuk ka veteran të ushtrisë, ka veteran të një lufte. Prandaj, konsiderojmë se duhet të jetë “veteranëve, pjesëmarrjes të Luftës Çlirimtare të Kosovës”.

Më tutje, vjen radha të përkufizohet. Te përkufizimet të përcaktohet çka nënkuptohet me Luftën Çlirimtare të Kosovës. Konsiderojmë se duhet të jetë “Lufta Çlirimtare e Kosovës është lufta e popullit shqiptarë kundër pushtuesit serb, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës”. Periudha është problematike, mund të jetë edhe pjesë e debatit këtu. Kjo terminologji, e cila është në titull e gabuar, konsideroj se duhet të përmirësohet pastaj në tërë ligjin, që të kursej kohën, mos t’i përmendi me radhë.

Vërejtje tjetër është lidhur me dëshmorët e kombit. Edhe këtu konsideroj që duke qenë se është e kufizuar lufta për lirinë e vendit në vitet 1998-99, nuk mund të quhet “dëshmorët e kombit” se konsiderojmë që ngushtohet shumë termin “dëshmorët e kombit”, nëse kufizon edhe kohën. Prandaj, mund t’i quajmë “dëshmorë të Luftës Çlirimtare ose të bëhet ndryshimi në kohë.

Kemi probleme, gjithashtu, edhe me përkufizimin “Veteran i UÇK-së” dhe konsiderojmë se te veteranët e UÇK-së, do të duhej të ishte kështu: “Veteran i Luftës Çlirimtare është qytetari i Kosovës dhe shtetas i huaj, i cili në mënyrë të organizuar ka punuar në përgatitjen, organizimin dhe zhvillimin e luftës së armatosur kundër pushtuesit serb” brenda periudhës së caktuar për të cilin papë them që duhet të debatohet. Kështu si është, konsideroj se është një formulim përjashtues.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me paragrafin, mungon në fakt me tërheqje nga Projektligji i kaluar, është hequr: “Pensioni personal i luftës së UÇK-së, të cilën e realizon Veterani i luftës së UÇK-së, pas moshës 50 vjeçare, Unë mendoj se duhet të kthehet si pika 1.4 këtu, te neni 5 dhe arsyetimi për këto është, edhe pse duke pasur parasysh implikimet buxhetore që mund t’i ketë, konsideroj se është një shumë, një masë jo shumë e madhe e njerëzve që e kanë tejkaluar moshën 50 vjeçare dhe gjithashtu është paraparë klauzola, në nenin 25, te benificionet, si subjekt i vështirësive fiskale, ku i lihet kompetenca Qeverisë që në rastet e caktuara të bëjë një reduktim ose anulim të përkohshëm të këtyre benificioneve, prandaj kjo mund të zgjidhet sipas situatës, pas përpilimit të listave të sakta.

E fundit, konsiderojmë se këtu duhet të kthehen paragrafët nga projektligji paraprak, ku parashihen benificionet për veteranët e UÇK-së, sepse këto i arsyetova pak më lartë

për arsye të cekura. Do të thotë, ekziston mundësia që të mbahet nën kontroll situata, përkundër implikimeve buxhetore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

I kisha thënë dy-tri fjalë unë, nga kjo pozitë që jam. Unë mendoj se ky ligj duhet të jetë ligj që njeh të gjitha kategoritë e Luftës Çlirimtare dhe të gjitha kategoritë e sakrificat e veçanta, por dhe me këtë duhet të mbyllet. Duhet të ishte ligj bazik dhe çdo kategori tjetër, për t'ju llogaritur kostoja më lehtë, do të duhej të ishte pastaj me ligje të veçanta.

Unë po e marr vetëm një shembull. Sigurisht që sa iu përket dëshmorëve të kombit, edhe të UÇK-së, do të duhej të ishte një listë dhe një ligj që e rregullon se kush mund ta ketë statusin e dëshmorit të kombit, dhe kjo formë e dëshmorëve të kombit do të duhej të miratohej në Kuvend dhe pastaj ka qenë lehtë të bëhet ligji dhe ligji të përcaktojë se si do të realizohet ai pastaj. Me një fjalë, është mirë që është ky ligj dhe për t'i zgjidhur disa probleme më të shpejta të kategorive të veçanta, por një ligj, ta ketë emrin e vet adekuat dhe t'i zgjidhë të gjitha kategoritë e njerëzve, që realisht janë të ndryshme, është e vështirë. Prandaj, ndoshta do të ishte mirë që komisioni ta marrë parasysh dhe vërtet të fillohet një ndarje, një kategorizim dhe pastaj krijimi i ligjeve të veçanta për kategori të veçanta dhe mendoj që zgjidhja do të ishte më adekuate se sa që mund të bëhet për krejt kategoritë me këtë ligj.

Megjithatë, e kemi si e kemi, tash komisioni duhet të përpiket të bëjë atë që mund të bëhet dhe ajo që mund të realizohet.

Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Më në fund, pas kërkesave peripecive dhe grevave të shumta, Qeveria solli për shqyrtim të parë këtë projektligj, jo për të privilegjuar këtë kategori, por për të kryer obligimin që e kemi dhe kjo është e pakta në krahasim me atë, çka kanë bërë ata për këtë popull dhe për këtë vend.

Prolongimi i këtij projektligji deri me tani nga Qeveria është arsyetuar me koston e lartë buxhetore, por me vlerësimin e ndikimit buxhetor nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, kanë konstatuar se projektligji nuk do të ketë nevojë për buxhet shtesë.

Për hartimin e këtij projektligji, sipas projektligjit janë konsultuar konventat ndërkombëtare të luftës, veçmas konventat e Gjenevës dhe Ligji kroat i luftës.

Ligji kroat i luftës do të ishte ideal, sepse kroatët vërtet i kanë trajtuar këto kategori ashtu siç e meritojnë. Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së dhe viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre ka

për qëllim që të përcaktojë statusin dhe përkrahjen financiare, që përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, të cilat me sakrificën dhe kontributin e tyre, ishin faktor vendimtar për lirinë dhe çlirimin e vendit.

Benificionet e veçanta janë: rehabilitimi mjekësor; shërbime shëndetësore; shërbime shëndetësore jashtë vendit; riaftësim profesional; përparësitë në punësim; lirimi nga tatimi, dogana; lirimi nga tatimet tjera; përkujdesja për banim; përparësitë në punësim dhe shumë beneficione të tjera për të cilat do të shprejsojmë që do të realizohen nga organet mbikëqyrëse të këtij ligji, sepse deri me sot benificionet nuk kanë qenë të shumta, por edhe ato beneficione nuk janë realizuar dhe nga personat që janë përgjegjës për këto kategori edhe janë injoruar, sepse kanë pritur në radhë para Ministrisë së Shëndetësisë për të përfituar ndonjë nga këto beneficione të cilat sot janë në projektligj.

Ndërsa, në nenin ku caktohen dhe definohen kushtet për të marrë epitelin e dëshmorit të kombit, të nderuar deputetë, ndoshta është bërë lëshim pa dashje, por ndoshta e tha edhe kryeministri edhe deputetët e tjerë, se nga kjo listë, me këtë periudhë të përcaktuar, shkurt 1998 - qershor 2009, në këtë periudhë mbesin pa u përfshirë si dëshmorë të kombit nismëtarët e luftës së UÇK-së, siç janë: Zahir Pajaziti, Luan Haradinaj, Edmond Hoxha, Ardian Krasniqi, Hakif Zejnullahu dhe shumë të tjerë. Por, shprejsoj se gjatë amendamentit të këtij projektligji në komisionin e caktuar do të rregullohet kjo çështje.

Në nenin 20, aktet nënligjore për zbatimin e ligjit, Qeveria dhe ministrinë përkatëse e kanë obligim nxjerrjen e rregulloreve për përcaktimin dhe kriteret dhe përmbajtjen e kartelës identifikuese për identifikimin e qartë të përfituesve të kësaj kategorie dhe udhëzimeve administrative për realizimin e të drejtave të përcaktuara me këtë ligj.

Sipas dispozitave të këtij projektligji njihet edhe përcaktohet statusi i veteranëve të UÇK-së, ndërsa të drejtat dhe benificionet për veteranët dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre do të rregullohen me ligj të veçantë. Të shprejsojmë se kjo kategori nuk do të mbetet pa përkujdesje dhe se Qeveria shpejt do të caktojë grupin punues për hartimin e këtij ligji.

Dhe, në fund, të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Është obligim moral i komisioneve përkatëse që do të formohen për të përcaktuar statusin e këtyre kategorive që të respektojnë gjakun e derdhur të dëshmorëve të kombit dhe dëshmorë të mos shpallen personat që kanë humbur në fatkeqësi komunikacioni apo në ndonjë formë tjetër, se është nënçmuese për këtë kategori që jetën e kanë dhënë në vijat e para të frontit apo kategoria e invalidëve të luftës, të cilët këtij vendi ia falën gjymtyrët e trupit, të barazohen me invalidë të punës ose ndonjë invalid tjetër, që invaliditeti i tij nuk ka lidhje me luftën e shenjtë të UÇK-së.

Njëjtë vlen edhe për veteranët e luftës, të cilët për muaj të tërë qëndruan në vijat e para të frontit, në misionin e shenjtë - mbrojtjen e atdheut, të krahasohen me njerëzit që kanë shëtitur nëpër diasporë apo nëpër rivierat bregdetare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ju e dini që edhe me kohë nuk jemi bash mirë, përsëri po e them, ju kisha lutur që ligjet që miratohen në parim dhe të gjithë ata që donë ta japin kontributin e tyre, ta japin në punën e komisionit. Ne po shkojmë sipas radhës. I kemi edhe 8 deputetë të lajmëruar për diskutime. Ju kisha lutur që vërtet më tepër të jenë në parim, se sot nuk e ndryshojmë këtë projektligj. Të gjithë ata që mund të kontribuojnë, le të kontribuojnë në komisione.

Po shkojmë sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Kolegë të respektuar deputetë,

Mbase e kemi të qartë se ky ligji është rikthyer nga tetori i vitit të kaluar, arsyet nuk do t'i potencoja. Kam pasur shpresë dhe kam qenë i bindur se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe grupet e interesit të cilat kanë punuar për ndryshimin e këtij ligji, do t'i marrin parasysh të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që kanë dalë jo vetëm tani, por që nga përfundimi i luftës për zgjidhjen e çështjes të kategorive të dala nga lufta.

Grupi punues në nivel qeveritar e ka theksuar se janë konsultuar konventat e Gjenevës, si dhe Ligji kroat i luftës. E para është me të drejtë, sepse ka të bëjë me të drejtat universale të rregulluara sipas konventave të miratuara në nivel ndërkombëtar. Por, kur të konsultohesh me ligjet e gabuara, këtu kemi edhe oficer që kanë qenë të armatës dhe i njohin se si i rregullon çështjet Ligji kroat i luftës, i marrë si matës, tregon kryekëput krijimin e monopolit mbi luftën çlirimtare, duke dhënë jo në mënyrë institucionale dhe gjithëpërfshirëse, por në shërbim të një krahu politik dhe në shërbim të vetëm të një pjese që kanë kontribuar për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Jam shumë i vetëdijshëm se Buxheti i Republikës së Kosovës dhe besoj se kjo vlen për të gjithë, nuk mund t'i shpërblejë të gjithë njerëzit që kanë kontribuar për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Për të argumentuar këtë dhe për të argumentuar që në listat e veteranëve të luftës ka më shumë veteranë se sa ka pasur në të vërtetë dhe cila është arsyeja pse janë fryrë këto lista, do t'i marr dy-tre shembuj. Dy - tri nenet e projektligjit, sidomos neni 3 që ka të bëjë me përkufizimet, me tërë tekstin dhe strukturën e që ndikon edhe në përmbajtjen, konsiston dhe nuk përfshin Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, apo njësitë operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të udhëhequra nga kjo ministri.

U tha qartë që duhet unitet, askush nuk po e konteston, por fatmirësisht të gjitha këto të organizuara që nga viti 1991, njerëzit e burgosur të asaj kohe, njerëzit e emëruar atë asaj kohe, që fatmirësisht nuk kanë vdekur në burgjet e Serbisë, nuk do t'i përmendi me emra, sepse i takon historisë, është e vërtetë dhe ata mund t'i dokumentojnë dhe t'i faktojnë të gjitha këto.

E dyta, është, ka të bëjë me organizatën e Luftës së UÇK-së, e cila është njëjës edhe në ligj, nuk thuhet organizatat, sepse ne kishim një organizatë tjetër e cila protestonte dhe ndikoi që të vjen ligji, nuk thuhet shoqatat, që do me thënë sipas këtij projektligji nuk mund të jenë ë shoqata apo organizata tjera, që janë organizim vullnetar, OJQ, që mund të kenë qasje institucionale, po ashtu lë në njëjës, e që krijon kryekëput monopol mbi këto vlera, ku kemi shumë shembuj se si përdoren dhe për çfarë qëllimesh. Do ta marrë vetëm një shembull. Ish komandanti i emëruar dy javë para se të përfundojë lufta, në një pyetje publike që i bën - a e njeh Tahir Zemajn dhe Salih Çekun, tha - jo, kurrë nuk kam dëgjuar për ta. Sot, në listat e organizatës së veteranëve të luftës, të pyetësh - a është Rexhë Osaj, Bashkim Balaj, Sinan Musaj, Ramë Peja, të vrarë tri ditë vetëm pse ishin ushtar dhe në njësitë operative që udhëhiqeshin nga Tahir Zemaj, të komanduara që njihnin për komandant suprem Ibrahim Rugovën, nuk janë në listat. Prandaj, këto janë arsyet pse kërkojmë që të jenë të përfshira me ligj, sepse fjalët harrohen. Ato që shkruhen, nuk mund të harrohen dhe i kontribuojnë edhe unitetit, edhe respektimit për të gjithë ata që kanë dhënë jetën për lirinë dhe pavarësinë e vendit.

E dyta, neni 15, njohja dhe rregullimi i statusit lidhet me këto të parat, por pika 7 ka të bëjë me komisionet. Po të krijohet një departament i luftës në kuadër të Ministrisë së Forcës së Sigurisë, që do të mbante dhe rregullonte statusin e veteranëve të luftës dhe të mos jenë të organizuar vetëm në shoqata apo ministritë individuale. Paramendoni sot të shkojmë te ministri Rashiq dhe t'i themi: unë kam qenë në njësinë operative kaq, kam luftuar dy ditë dhe kërkoj statusin, sa ka për të dhënë njohuri dhe përparësi.

Për fund, të nderuar kolegë deputetë, njohja e sakrificës që është me ligj, e kam thënë edhe herën e kaluar dhe kontributi që ka dhënë Komandanti legjendar Adem Jashari, i bën nderë Kuvendit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës, por historia do ta përmirësojë pasi të kuptojë të drejtën historike se Adem Jashari, Sali Çekaj dhe Zahir Pajaziti, si themelues të parë të bërthamave të mbrojtjes çlirimtare, që janë tri shtyllat kryesore të luftës të armatosur për çlirim në Kosovë, janë një dhe të pandashëm dhe jam shumë i bindur se këto duhet të ndryshohen në të ardhmen. Unë i jap përkrahje ligjit në parim, besoj që komisioni, e kam bindjen, nuk ka kapacitete t'i bëjë këto ndryshime, por duhet një konsensus politik dhe një vullnet i kryeministrit të vendit dhe i Qeverisë që të bëhen këto përmirësime dhe ndryshime në këtë ligj. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Ju faleminderit, kryetar!

Ju përshëndes të nderuar deputetë!

E përshëndes edhe sjelljen e këtij ligji në Kuvend! Është e vërtetë që është vonuar, por është një ligj shumë i ndërlikuar dhe fakti që të gjitha qeveritë e kanë pasur nëpër dorë dhe nuk e kanë përfunduar, është argument, madje edhe të gjitha vendet që kanë qenë ballafaquar me këtë problematikë, po ashtu janë vonuar.

Me sa di unë, nuk mund të konsiderohet madje punë e kryer sa e si duhet mirë as në vendet që u përmendën, në Kroaci e gjetiu, megjithëse për ne është përvojë e mirë dhe mendoj që ligji ka qenë dashur të mbështetet edhe më shumë.

Unë mendoj që ligji është më i mirë se ai i mëparshmi, por është më restriktiv. Ç'është e vërteta, do kufizime duheshin bërë dhe mendoj që është mirë që i është hyrë kësaj pune, por nuk besoj se kufizimet duhet të përjashtojn rrënjën, siç ka ndodhur. Kryeministri foli për të dhe unë nuk dua ta zgjas, por vetëm dua ta mbështes atë që u tha dhe besoj që do të bëhet me amendamentim, por do të insistoja që edhe kufizimi në anën tjetër të rishikohet, sepse nuk është çështja e luftës thjeshtë me një datë që përfundon, gjithkund lejohen edhe raste të veçanta. Është edhe ajo, është bërë një përjashtim të viktimat civile, thuhet atje që kanë rënë në mina, po përveç minave të ushtrisë, ka pasur edhe do mina politike të mëvonshme, ka pasur edhe disa shkëndija të mëvonshme, ka pasur edhe do luftëra dhe do ushtri që po ashtu kanë dhënë dëshmorë dhe heronj dhe mendoj se duhet të përfshihen edhe ata. Ka qenë e njëjta luftë, i njëjti karakter dhe e dimë si ka qenë e kaluara. Lufta ka qenë e përbashkët dhe, për mendimin tim, nuk mund të përjashtohen lehtë luftëtarët që kanë rënë edhe në Karadak e tutje.

Ligjit mund t'i bëhen edhe disa korrigjime të natyrës ndërtimore, për shembull Ligji korat bën kategorizimin e përfituesve dhe mendoj kjo është mangësia kryesore e këtij ligji. Është e vërtetë që është zor ta bëjë komisioni dhe e mira do të ishte ndoshta që kjo të bëhet me një akt të veçantë, me një ligj të veçantë për përfitimet.

Nuk e kuptoj pse në ligj është bërë një shquarje ose theksim i disa dispozitave me bollëk të tjerat nuk janë kështu, çka do të thotë? Është një praktikë e pazakonshme dhe mendoj që do të duheshin sqaruar - pse është ajo.

Uroj që gjatë amendamentimit në komision të merren parasysh edhe vërejtjet që u thanë dhe sa më shpejt kategorive të dalë nga lufta t'u jepet një ligj, siç e meritojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Deputeti Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Po provoj që shumë shkurt të jap një kontribut në lidhje me këtë ligj. Mendoj se nuk ka nevojë të them se me plotë vullnet dhe qenie e mbështes në parim projektligjin. Kur diskutojmë në parim dhe në aspektin filozofik të projektligjit, mendoj se po na dalin disa probleme të vogla, në fakt nuk janë probleme, por janë çështje për të cilat Kosova duhet të fillojë të mendojë edhe gjatë leximit të dytë, duhet të mendojmë.

Vetë fakti se debati nuk është rreth çështjes se çfarë do të bëjë shteti për veteranët, invalidët, do të thotë të gjithë ata njerëz, mos t'i përmend, që kanë dhënë për Kosovën, por debati më shumë po fokusohet se kush është veteran, kush është viktimë civile, kush është invalid, është problem në vetvete i Kosovës dhe ne duhet të vendosim njëherë cila është pyetja, a është pyetja këtu çka po duam të bëjmë ne për veteranët, për invalidët dhe për viktimat dhe familjet e tyre apo duam të debatojmë se kush janë ata.

Nëse ne kemi dilema se kush janë, atëherë duhet provuar me kujdes, pak të vendosim vet edhe pak t'ia lëmë historisë për shkak se fundi i fundit, në këtë Kuvend të Kosovës janë mbi 30 njerëz që kishin me automatizëm për t'u kualifikuar si veteran të luftës, të paktën, që i numëroj unë, mundet edhe të më ikën dikush dhe i kërkoj falje nëse më ikën dikush, domethënë edhe në Qeveri edhe në Kuvend, përmbi 30 njerëz janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë të luftës, po them njerëz, ndoshta fjalë e gabuar, por po flas edhe për burra edhe për gra.

Një çështje tjetër për të cilën flitet këtu, është riaftësimi profesional. Mendoj se duhet pasur kujdes me fjalën: "riaftësim", se kur të themi riaftësim, po mendojmë për dikë që ka qenë i aftësuar dhe ka harruar, njëfarë amnezioni ka pasur dhe ka harruar zanatin dhe duhet t'ia rimësojmë zanatin. Mund të flasim për aftësim profesional, për riaftësim është njëfarë doze serioze e fyerjes t'i thuhet dikujt se po të riaftësojmë profesionalisht.

Tani, mendoj se shtetet, sikur shteti ynë, duhet të shohin përpara edhe përkundër rrezikut që ajo që do të them unë, - të ketë një dozë të vogël kontraverze, unë prapë se prapë do ta them. Ne po themi se po e kryejmë një borxh. Nëse dikush ka punuar për shtetin dhe e konsideron borxh që shteti ka ndaj tij, ai individ mund të kualifikohet si mercenar. Dëshmorët edhe të gjithë të tjerët nuk lypin borxh prej shtetit, domethënë nuk po flasim për kthim borxhi këtu, nuk po flasim për t'ua kthyer borxhin, qoftë familjeve, qoftë të gjithë atyre njerëzve që u njohim qoftë merita, qoftë djersën, qoftë gjakun. Ne po flasim për një veprim të një shteti që sheh përpara dhe vet fakti që ne po kujdesemi për një trajtim adekuat, për një status adekuat në shoqëri të njerëzve të cilët kanë dhënë shumë për vendin, ne po provojmë që përmes këtij veprimi të ndikojmë që gjeneratat që vijnë ta kuptojnë se puna për vendin nuk shkon totalisht huq.

Nëse hyjmë në rrugën që mendojmë se me një ligj të tillë kthejmë borxh, atëherë mendoj se, në esencë, në vetvete, në mënyrë implicite i gjithë debati e mbanë njëfarë fyerje, se askush nuk ka shkuar në luftë për t'ia kthyer borxhin dikush. Kanë shkuar vullnetarisht për të dhënë krejt çka kanë për vendin, do të thotë vetë fjala ose në mënyrë implicite nëse flasim për një kthim të një borxhi, është shumë e gabueshme, siç është edhe riaftësimi profesional, në atë kuptimin tjetër. Tani po them edhe një herë, pyetja jonë duhet të jetë: cilat janë kapacitetet e shtetit të Kosovës që të përkujdeset në mënyrë adekuate për të gjitha këto kategori për të cilat po flasin, po flasin në mënyrë që secili individ që ka lindur dhe lind prej sot e tutje, ta kuptojë se për këtë shtet patriotizmi është diçka që çmohet nga secili prej nesh, si njësi dhe nga tërësia.

Dhe, e fundit që po dua të them, është e vërtetë që një pjesë e madhe e projektligjit është bazuar në Ligjin kroat, por nëse në Kuvendin e Kosovës i referohemi shumë shpesh Ligjit kroat, po ma krijon njëfarë ndjenje, njëfarë ndjesie inferioriteti. Nuk është me rëndësi cilit ligj i referohemi ne, ne po e bëjmë ligjin tonë dhe nëse në vazhdimësi ju referohemi me emër se cilët ligje i kemi konsultuar, por krijon ndjesi, për mendimin tim po krijon ndjesi të çuditshme, kështu që mendoj se po flasim për ligj të Kosovës. Nuk është turp të tregojmë se i kemi konsultuar ligjet tjera, por nëse gjatë shqyrtimit në parim bëjmë krahasime në mes të ligjit tonë dhe cilitdo ligj tjetër, po më krijon një ndjesi e cila, po e quaj, ndoshta prapë nuk po gjejë fjalë tjetër, po më

mungojnë fjalët tani edhe është gabimi im, po më krijon ndjesi të inferioritetit. Sidoqoftë, edhe një herë po mendoj se po e bëjmë një punë të mirë si Kuvend që po e kalojmë këtë ligj. Mendoj se historia ka për të pasur punë për shkak se debati po na sillet në atë se kush është dëshmor dhe kush është ai që duhet të ketë benifite, që nuk duhet të ishte e këtillë. Sidoqoftë, edhe një herë mendoj se kontributi im do të ndikojë që gjatë shqyrtimit në leximin e dytë nëpër komisione, ligji të bëhet edhe pak më i mirë se sa që është, edhe pse besoj se edhe si i tillë është mjaftueshëm i mirë për të kaluar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Justina Pula.

JUSTINA PULA: Zëvendëskryeminsitër, ministra dhe deputetë, Shumë deputetë këtu i dhanë mendimet e tyre dhe kontribuan që ky ligj të jetë shumë i arsyeshëm dhe cilësor. Unë do të flas për një kategori, nuk e di a i takon ndoshta këtij ligji apo ndonjë ligji tjetër, pasi që nuk kemi ligj tjetër, unë do ta shpreh opinionin dhe mendimin tim.

Kur flasim për viktimat e luftës, shumë mirë e dimë se në mes të tyre ka pasur shumë gra të cilat kanë përjetuar dhuna të ndryshme gjatë luftës. Duke u nisur prej atyre që janë shtyrë të shikojnë masakrimin e anëtarëve të familjes, të fëmijëve, e deri te ato që janë ekspozuar direkt dhunës në forma të ndryshme. Një ndër dhunuat më të rënda, ishte dhunimi. Dhunimi i grave është përdorë si mjet lufte, me një qëllim që të shkatërrohet celula e familjes dhe dinjiteti njerëzor. A duhet dikush të kujdeset për këto viktima, ku janë ato sot, a kujdeset kush për ato?

Këto gra kanë nevojë për përkrahje, për trajtime të ndryshme psikike dhe emocionale. Ne kemi për detyrë t'i përkrahim dhe t'u ofrojmë ndihmë.

Sa për informatë, Rezoluta e Këshillit të Sigurimit, Rezoluta 1325, Rezoluta 1820, Rezoluta 1888, Rezoluta 1889 për gra, sigurinë edhe paqen, dhunën seksuale e trajtojnë si krim. Kërkon që vendet që dalin nga lufta, gratë e dhunuara t'i njohin si viktima të luftës dhe në kohën e fundit, kërkohet që përdhunuesit të dalin para ligjit.

Këto gra-vajza duhet të hyjnë në këtë ligj, si kategori e viktimave. Kjo nuk do të paraqet asgjë të re. Në Ligjin e Bosnjës dhe Hercegovinës, edhe pse Ardiani tha - nuk duhet të bazohemi në ligjet e shteteve tjera, po pavarësisht, na jep një pasqyrë dhe na jap një informatë se çka po ndodhë në shtetet të cilat kanë të njëjtën situatë dhe kanë qenë në një tranzicion, gratë viktima të dhunimit janë marrë parasysh dhe gëzojnë benifite si gjithë viktimat tjera të luftës. Prandaj, unë mendoj që ky ligj duhet në parim të përkrahet, mirëpo të përllogariten apo të merren edhe të gjitha kategoritë tjera të cilat nuk janë paraparë me këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Sigurisht, komisioni do ta ketë parasysh këtë, edhe ajo kategori hynë në kategorinë e viktimave të luftës, por duhet të specifikohet.

Deputeti Haki Demolli e ka fjalën!

HAKI DEMOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Fillimisht duhet të them se edhe unë në parim e përkrah dhe e përshëndes dhe e mirëpres procedimin e këtij ligji për procedurat e mëtutjeshme. Me qëllim që të jem sa më i shkurtër, unë do të ndalem në vetëm një nen dhe atë fjala është për nenin 25.

Sipas mendimit tim, ky nen tregon se Qeveria është në gjendje t'ju premtojë qytetarëve, pensionistëve, të papunëve, madje edhe familjarëve të dëshmorëve dhe invalidëve e luftës edhe premtime të cilat janë të perealizueshme. Kur e them këtë mendim, e bazoj në pikën 1 të nenit 25, i cili thotë, citoj: “pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, pagesat e cilit do dhe të gjitha benificionet financiare, të parapara me këtë ligj, duhet të kërkojnë vetëm deri në atë masë që i ka fondet e mjaftueshme, faktikisht me dispozicion për pagesa të tilla.

Pra, kjo tregon se në njërin anë me këtë ligj parashihen benificionet e ndryshme për dëshmorët, veteranët dhe familjet e tyre, siç janë: bursat; shërimi; shkollimi; energjia elektrike; lirimi nga taksat doganore; transporti publik e tjera, e nga ana tjetër, të drejtat themelore të tyre që kanë të bëjnë me të holla apo para, respektivisht pensionet e tyre, nuk janë të sigurta, sepse sipas alinesë 2 të nenit 25, citoj prapë: “Qeveria do të ketë autoritetin që të lëshojë një vendim që redukton apo eliminon çfarëdo benificioni për të siguruar me këtë ligj, përfshirë edhe benificionet që kanë të bëjnë me pagesa financiare”. Andaj, propozoj që ky nen të fshihet në tërësi, sepse me fshirjen e tij, do të forcohet dukshëm pozita, statusi dhe të drejtat e kategorive të luftës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputetja Blerta Deliu Kodra e ka fjalën!

BLERTA DELIU KODRA: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuari kryetar,

I nderuari kryeministër,

Zëvendëskryeministra dhe ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të viktimave civile dhe të familjeve të dëshmorëve dhe familjeve të tyre, është i shumëpritur dhe jo vetëm për këto kategori, por që ky projektligj i trajton, por nxjerrja e këtij projektligji, për më shumë, është një satisfakcion moral ndaj të gjitha kategorive që në një mënyrë apo në tjetër ishin pjesë dhe kanë lënë gjurmë në historinë më të re të vendit tonë.

Duk ju referuar përmbajtjes së këtij projektligji, vijmë në përfundim se kemi të bëjmë me një ligj që për kategoritë e lartpërmendura lirisht mund të referohemi si ligj bazik. Prandaj, mendoj se duke pasur në konsideratë materien që e trajton ky projektligj, një qasje meritore nga Kuvendi i Kosovës dhe komisionet parlamentare, në një procedurë të rregullt kuvendore, është më se e nevojshme, në mënyrë që në fund të kemi edhe një ligj organik dhe të zbatueshëm.

Projektligji në fjalë ofron një kornizë solide për trajtim dinjitoz të statusit të kategorive të dala nga lufta, i plotëson kriteret bazë për miratim dhe atë duke u bazuar në faktin se projektligji në mënyrë gjithëpërfshirëse trajton materien që i dedikohet, krijon obligime, adreson përgjegjësi. Megjithatë, konsideroj se në këtë projektligj duhet të trajtohet me më seriozitet nën 12, paragrafi 2, ku thuhet se të drejtat dhe benificionet për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do të rregullohen me një ligj të veçantë. Konsideroj se duhet të përcaktohen qartë këto benificione. Duke qenë e vetëdijshme se asnjëherë nuk mund të pretendohet që përmes një projektligji të trajtohen në detaje të gjitha brengat, preokupimet dhe shqetësimet e kategorive të dala nga lufta, mendoj se vendosja në prioritet të legjislativit, respektivisht kompletimi i pakos ligjore për këto kategori, duhet të mbetet përkushtim parësor i legjislativit të vendit, gjithmonë e kam fjalën për obligimet që dalin nga nën 12 i këtij projektligji. E përkrah në parim projektligjin dhe besoj se në procesin e amendamentimit projektligji do të marrë trajtën meritore, në mënyrë që edhe vërejtjet eventuale në këtë projektligj të evitohen. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Edhe diskutuesi i fundit, deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Sot po shqyrtojmë në lexim të parë Projektligjin për statusin dhe të drejtat de dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimat civile dhe familjeve të tyre.

Ligji në strukturën është i mirë dhe plotëson nevojat e statusit për të drejtat të kategorive që trajton ky ligj.

Të nderuar deputetë,

Besoj që ky ligj do të plotësohet me vërejtjet e deputetëve gjatë kësaj seance, si dhe gjatë shqyrtimit të tij në komisionin përkatës. Ajo që unë mendoj se duhet të ndryshojë, është vetë titulli i ligjit, duhet të jetë: “Statusi dhe të drejtat e familjeve të veteranëve, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, sepse, në rast se e lëmë veteranëve, pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të ketë polemika kush ka qenë veteran dhe kush pjesëtar i Ushtrisë i Çlirimtare të Kosovës.

Kjo i bie se veteran do të jem unë, kryeministri, Xhaviti, ndërsa kryetari i Parlamentit, që ka qenë edhe zëvendës komandant i Shtabit të Përgjithshëm dhe zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zoti Ahmet Isufi që më paska ikur prej salle, ka qenë komandant zone, i bie të jenë veç pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, se më ’98 janë angazhuar, apo sipas këtij ligji, dy nga tre kryetarët e shoqatave të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk kanë qenë veteranë, por kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Nuk kemi të lajmëruar për diskutim. Debatin mund ta zhvillojë në komisionet përkatëse.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim dhe votojmë, tash.

Votojmë në parim.

Në sallë kemi 61 deputetë, 59 deputetë kanë votuar “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim. Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, të shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftojë ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar!

I nderuari kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për zjarrfikje dhe shpëtim, të sponsoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Projektligji për zjarrfikje dhe shpëtim është hartuar duke u bazuar në Strategjinë legjislative të Qeverisë të Republikës së Kosovës për vitin 2011, dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e Punës së Qeverisë, numër 01-2007. Qëllimi i këtij projektligji është sigurimi i mekanizmave reagues, efektiv për zjarrfikje me qëllim të shpëtimit të njerëzve dhe të pasurisë në situata emergjente.

Arsyeja për hartimin e këtij projektligji qëndron në faktin se aktualisht në Republikën e Kosovës nuk ekziston Ligj për zjarrfikje dhe shpëtim. Pjesërisht fusha e zjarrfikjes është rregulluar me Ligjin për mbrojtje nga zjarri, 2/L-41, i cili nuk e ka rregulluar në tërësi fushëveprimin e zjarrfikjes dhe shpëtimit. Pra, për këtë projektligj themelohen njësitë e zjarrfikjes dhe shpëtimit, si dhe si dhe njësitë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, njësitë e zjarrfikjes dhe shpëtimit në industri dhe njësitë e shoqatave vullnetare të zjarrfikësve dhe shpëtimit. Pra, me këtë projektligj rregullohet...

(Ndërprerje e incizimit)

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Përdore edhe një herë zilen! Zoti ministër, mund ta vazhdoni ju se në rregull është me numër, tani ulën të gjithë!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuari kryesues,
Të nderuar deputetë, po vazhdoj aty ku mbeta. Ky Projektligj përmban 8 kapituj dhe gjithsej 26 nene, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare. Hartimi i Projektligjit është bërë në pajtim me procedurat e parapara dhe për këtë Projektligj janë pranuar edhe deklaratat respektive nga Ministria për Financa dhe Ministria e Integritetit Evropian, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me aquis-communitaire.

Të nderuar, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ju lus për miratim të këtij projektligji.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!
Tani sipas radhës, fjalën e ka raportuesi i Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri, Mbikëqyrje të Forcave të Sigurisë, deputeti Xhelili, apo Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, nënkryetar,
I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar deputetë,
Unë fjalën e marr në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, jo në emër të komisionit. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka analizuar Projektligjin për zjarrfikje dhe shpëtim. Kontributin e vet do ta japë përmes anëtarëve në Komisionin përkatës, ku do t'i paraqesë gjithashtu edhe vërejtjet dhe sugjerimet dhe ne si grup parlamentar e përkrahim miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Vjollca Krasniqi është e paraqitur.

VJOLLCA KRASNIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe vlerëson se ky projektligj nuk është i harmonizuar dhe i koordinuar në mes të ministrive të cilat kanë dhënë opinion dhe vlerësime për këtë projektligj, siç është Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Integritetit Evropian apo edhe Ministria e Financave.

Ky projektligj, ashtu siç tha edhe ministri, nuk është voluminoz, ka diku 26 nene, mirëpo është projektligj që është përpiluar ekskluzivisht për të bërë centralizimin e

shërbimeve të zjarrfikjes nga niveli komunal në atë qendror, gjegjësisht në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Momentalisht, shërbimet e zjarrfikjes janë pjesë e strukturës së komunës dhe financohen nga buxheti i komunës përmes grantit të përgjithshëm apo të hyrave vetanake. Gjithnjë duke u thirr në opinionin dhe vlerësimin e Ministrisë së Financave, ky projektligj është vështirë i realizueshëm, sepse buxheti duhet t'u merret komunave dhe t'i transferohet Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke pasur parasysh se është në kundërshtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Ligjin për financat e pushtetit lokal. Gjithashtu, Departamenti i Buxhetit shpreh dilemën e mundësisë ligjore dhe funksionale që buxheti dhe stafi nga komunat të transferohet në ministri dhe çfarëdo pengese në realizimin e këtij transferimi, Ministria do t'i kushtojë me buxhet shtesë të cilin nuk e ka të planifikuar as me kufijtë buxhetor për vitin 2011-2013, dhe as me kornizën afatmesme buxhetore.

Përveç kësaj, dilemat që janë edhe në shfrytëzimin e stacioneve të shërbimit të zjarrfikjes dhe shpëtimit apo objekteve, objekte këto të cilat janë shumica prej tyre në pronësi të komunave dhe çka nëse këto objekte nuk mund të shfrytëzohen nga Ministria e Punëve të Brendshme, atëherë duhet ndërtuar të reja, duhet marrë me qira apo çfarë tjetër kur nuk janë paraparë mjete buxhetore?

Ministria e Financave ka identifikuar dhe paraqitur koston buxhetore 2011-2013 dhe kjo kosto ka të bëjë me themelimin dhe funksionalizimin e njësive të zjarrfikësve në tri komuna të reja, sipas pakos së Ahtisarit, ndërsa ne sot këto kompetenca po i centralizojmë dhe po i vejmë në nivelin qendror. Komunat, që është shumë jo logjike, me këtë projektligj janë të obliguara të inkurajojnë themelimin e shoqatave vullnetare të zjarrfikjes apo stafe vullnetare, gjë që mendoj se komuna është institucioni më afër qytetarëve. Prandaj, gjithmonë duke u thirr në vlerësimin e Ministrisë së Financave, kemi të bëjmë me një projektligj që ka ndikime buxhetore, kemi të bëjmë me një projektligj që ka paqartësi dhe mund të jetë ndesh me legjislacionin në fuqi, andaj edhe rekomandimi i Ministrisë është që ky projektligj, si i tillë, nuk mund të aprovohet përderisa drafti i fundit i projektligjit, që do të duhej të kthehej edhe një herë në Qeveri, të mos jetë ndesh me legjislacionin në fuqi.

Andaj, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike mendojmë që ky projektligj duhet të kthehet edhe një herë në Qeveri dhe të mos ketë ndeshje legjislative, ashtu siç i ceka më herët. Ju faleminderit!

KRYESUSESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, nuk ka të paraqitur. Në emër të AAK-së, deputeti Isufi e ka fjalën!

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shqyrtimin e parë të Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim e kemi trajtuar edhe në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në parim e përkrahim dhe do t'i kemi vërejtjet tona edhe si Grup Parlamentar në amendamentim në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Novobërdaliu!

SUZAN NOVBËRDALIU: Faleminderit kryesues!
Edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar këtë projektligj, të njëjtin e përkrahim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputeti Kinolli!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, kryesues!
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë projektligj për zjarrfikje dhe shpëtim dhe e përkrah të njëjtin dhe e jep dritën e gjelbër për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur të tjerë! Zoti ministër, dëshironi fjalën? Zoti Rexhepi e ka fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Realisht, edhe në Memorandumin shpjegues janë shpjeguar, janë precizuar, kjo ka qenë kompetencë e deleguar, janë harmonizuar të gjitha dhe po ashtu ekziston përgjigja ndaj rasteve emergjente lokale, është kompetencë e komunave për Ligjin për vetëqeverisjen lokale, dhe zjarrfikja është një prej tyre. Këto janë të harmonizuara, ne mund ta çelim prapë, por kthim nuk mund të bëhet, sepse janë harmonizuar të gjitha.

KRYESUESI: Faleminderit!
Atëherë, në sallë janë 63 deputetë! Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani.

A ka pa kartelë? S'ka. Atëherë, konstatoj se me 43 vota “për”, 13 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për zjarrfikje dhe shpëtim.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës, që është:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Kuçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin. Zoti Kuçi, e keni fjalën!

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që në pika të shkurtra të prezantoj Projektligjin për mbrojtjen e informatorëve për shkak të rëndësisë dhe rolit preventiv dhe mënjanimi të korrupsionit dhe me qëllim të krijimit të masave legislative për të nxitur informatorët për informimin e veprimeve kundërligjore, me qëllim që me ligj të rregullohen kushtet dhe procedurat e mbrojtjes së informatorëve, kemi propozuar këtë projektligj.

Informatori i cili informon me mirëbesim autoritetin përkatës brenda institucioneve publike në nivel qendror apo lokal, në institucione dhe ndërmarrjet publike apo private, për çdo ndryshim të arsyetueshëm për ekzistimin e veprimit kundërligjor, shpeshherë iu ekspozohet rreziqeve të shumta, viktimizimit, pushimit të punës e tjera, ndërsa në raste ekstreme madje edhe rrezikut fizik, për çka është e nevojshme që të bëhet sigurimi adekuat i tij.

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është prioritet nacional i Republikës së Kosovës në këtë proces të integritetit euro-atlantike. Kundërshtimi efektiv kundër korrupsionit kërkon pjesëmarrje aktive të Qeverisë, të gjithë sektorëve të jetës publike, të akterëve të shoqërisë civile, po edhe të qytetarëve veç e veç. Në këtë kontekst, informatorët kanë një rol të rëndësishëm në preventivën dhe mënjanimin e korrupsionit, në ngritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së pushtetit publik në Kosovë.

Meqenëse mbrojtja e informatorëve në Kosovë deri më tani nuk ka qenë e rregulluar me ligj dhe po ashtu është bërë përpjekje që ky institut përkatësisht të drejtat e tyre të rregullohen në mënyrë adekuate dhe të plotë dhe me qëllim të sigurimit të tyre nga cilido punëdhënës, qoftë publik apo privat ose edhe nga ndonjë qytetar, ata duhet të sigurohen me këtë projektligj. Ne duhet ta pranojmë faktin se informatorët janë realitet në Kosovë dhe ata duhet që të mbrohen edhe me ligj sipas veprimeve të parapara me këtë.

Unë ju ftoj, të nderuar deputetë, që të jepni kontributin tuaj. Ky është një prej projektligjeve që kërkohet edhe në Raportin e progresit dhe në luftimin e dukurive negative në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, tani hap debatin për diskutim në parim. Sipas radhës, është kryetari i Komisionit për Legjislacion, zoti Gashi. Nuk është këtu! Vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Behar Selimi!

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike pajtohet që Projektligji të aprovohet në parim.
Për më tepër, inkurajojmë edhe deputetët tjerë që të veprojnë njësoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Haki Demolli!

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Do të mundohem që të jem sa më i shkurtër, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së do të paraqes disa vërejtje, komente dhe sugjerime lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e informatorëve.

Vërejtja jonë e parë ka të bëjë me vetë emërtimin dhe përmbajtjen e projektligjit, sepse projektligji emërtohet si Ligji për mbrojtjen e informatorëve, kurse kur e shikojmë brendinë e ligjit, atëherë shohim se në vetëm 3 nene të vetme flitet për mbrojtje dhe atë në mënyrë shumë sipërfaqësore por, për habi, në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk rregullohen as kushtet për mbrojtje, as procedurat, as mjetet, as masat për mbrojtje, as ndëshkimet eventuale për ata që nuk i afrojnë mbrojtje, respektivisht cenojnë masat, procedurat e mbrojtjes së informatorëve.

Andaj, thjeshtë, si Grup parashtrojmë pyetjen, si mund të quhet ky projektligj si Projektligj mbi mbrojtjen e informatorëve?

Vërejtja tjetër ka të bëjë me vetë objektin dhe qasjen e përgjithshme të këtij ligji. Sipas dispozitave të këtij ligji, objekt i rregullimit me normë juridike është veprimtaria e informatorit për informimin mbi ekzistimin e veprimeve kundër ligjore si korrupsioni, veprat penale kundër fondeve ndërkombëtare dhe fondeve publike, të cilat sipas legjislacionit në fuqi mund të paraqesin edhe krime serioze.

Andaj, shtrohet pyetja, pse ky informator të informojë për vepra penale të rënda punëdhënësin dhe institucionet publike e jo organet kompetente që merren me luftimin e krimit, siç janë policia dhe prokurori i shtetit.

Pse të bëhet dublifikimi i veprimeve, a thua më të besueshëm janë punëdhënësit në luftimin e krimeve serioze, siç janë korrupsioni dhe krimet tjera të rënda se sa vetë organet kompetente shtetërore?

Dhe, vërejtja e tretë, e përgjithshme, ka të bëjë me mënyrën e rregullimit të veprimtarisë së informatorit, sepse vërtet kjo veprimtari nuk është rregulluar në mënyrë të tërësishme, por parciale. Ky ligj nuk e trajton fare fatin e mëtutjeshëm të informatës së argumentuar, respektivisht nuk përcakton as masat ndëshkimore, as procedurat konkrete në rastet kur cenohen dispozitat mbi aktivitetin e informatorit.

Krejtësisht në fund, do të theksoja se Grupi Parlamentar i LDK-së edhe përkundër vërejtjeve të theksuara për Projektligjin mbi mbrojtjen e informatorëve, duke pasur parasysh nevojën për plotësimin e kërkesave që dalin nga Raporti i progresit, në parim është për procedimin e mëtutjeshëm të këtij ligji dhe njëherësh kërkon që i njëjti të plotësohet e të ndryshohet me amendamentet përkatëse të cilat do ta bëjnë më funksional dhe më kuptimplotë këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, s’është paraqitur askush. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK, deputetja Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe e përkrah në parim. Rekomandojmë që të gjitha sugjerimet tona të shkojnë përmes përfaqësuesve tanë në grupet punuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, deputetja Suzan Novobërdaliu!

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e informatorëve dhe të njëjtin e përkrah në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! SLS, nuk ka të paraqitur! “6+”, deputetja Mufera Shinik!

Teşekkür ederim sayın başkan vekili,

Milletvekili Behar Selimi’nin teklifi üzere kısa kismaya çalışıyoruz. 6+ Parlamenter Grubu olarak bu Yasa Tasarısını kabul ediyoruz ve komisyonlarda katkımızı sunacağız.

Teşekkür ederim

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur! Përfaqësuesi i Qeverisë, dëshiron të sqarojë edhe pak. Zoti zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Veç një sekondë! Faleminderit, se s’do t’ju marr kohë shumë. Unë i pranoj sugjerimet, vërejtjet dhe besoj se edhe komisioni dhe deputetët do t’i japin përgjigjet e tyre. Do të provoj profesorit Demolli t’ia jap përgjigjen.

Është e vërtetë, zoti profesor, që ka nevojë të plotësohet, por ajo çka duhet të them, që me këtë rast po nxiten njerëzit që punojnë në shkallë më të ulëta brenda institucioneve publike ose private, që për shfat e tyre direkt lajmërojnë te do shefa më të mëdhenj dhe me Ligjin apo me Kodin penal përgjegjësi i institucionit në momentin kur merr vesh që është kryer vepra penale, nëse nuk e procedon, kryen vepër penale. Do të thotë, ky është qëllimi ynë që t’i nxisim njerëzit, të bashkëpunojnë dhe ata nëse shfat e tyre nuk e bëjnë një gjë të tillë, atëherë do të kenë logjikë...

(Ndërhyrje)

Ndërsa... Ismeti po thotë i nxit për të spiunuar! Unë po them se ata, ashtu kështu, Ismet, po spiunojnë, por ne po i mbrojmë me ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve. Në mbledhje janë prezent 62 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Faleminderit! Konstatohet që me 58 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e informatorëve.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportet me rekomandime. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës, që është:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat mbrojtëse të importeve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, zotin Besim Beqaj që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit... Apo ia ka lënë dikujt tjetër. Atëherë, zoti zëvendëskryeministër Kuçi, para deputetëve të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën, rregullimin dhe përmbajtjen e Projektligji për masat mbrojtëse në importe.

Qëllimi i këtij projektligji ka të bëjë me zbatimin e masave mbrojtëse me importin në funksion të rregullimit të tregut dhe mbrojtjes së prodhuesve vendorë, sa herë që ata dëmtohen apo kërcënohen nga dëmtimi serioz, nga importi i mallrave të cilat ndikojnë në çrregullimin e tregut.

Ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, pasi që me aprovimin e këtij ligji do të plotësohet vakumi ligjor i cili ka ekzistuar deri më tani.

Përderisa vendet e rajonit dhe më larg zbatojnë legjislacionin me të cilin rregullohet mbrojtja e prodhuesve dhe e prodhimeve vendore nga importet me efekte çrregulluese, ne ende po e kompletojmë legjislacionin në këtë fushë të rëndësishme ekonomike e tregtare.

Ky projektligj mundëson mbrojtjen e prodhuesve vendorë sa herë që ata dëmtohen apo kërcënohen për t'u dëmtuar nga importi i pa kontrolluar i sasive të mëdha të produkteve të huaja.

Zbatimi i këtyre masave vendoset mbi bazat e një hetimi të kryer, nëse është vlerësuar si produkt i importuar, ka shkaktuar dëm ose tenton të shkaktojë kërcënim serioz për prodhuesit e mallrave të njëjta në vendin tonë.

Zbatimi i këtyre masave do të ndikojë në mbrojtjen e prodhimeve vendore, rritjen e aftësive konkurruese të prodhuesve vendorë, stabilizimin në furnizimin e tregut, rritjen e cilësisë së prodhimeve vendore dhe rregullimin në tregun në përgjithësi.

Miratimi i këtij projektligji ka për qëllim përmbushjen e prioriteteve të Qeverisë dhe plotësimin e harmonizimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së, prandaj ju lus, të nderuar deputetë, që ta përkrahni në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani hapim debatin për diskutim. Sipas radhës, kryetari i Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Infrastrukturë, në mbledhjen e radhës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në përputhje me Rregulloren e Kuvendit i rekomandon aprovimin, në parim. Po ashtu, mirëpresim çdo kontribut të deputetëve në fazën vijuese për ta trajtuar këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani grupet parlamentare. Sipas radhës, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së, e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe kontributin e vet do ta japë në komisionin në vazhdim. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i LDK-së, deputetja Teuta Sahatqija!

TEUTA SAHATQIJA: Projektligji në fjalë i rregullon parimet dhe procedurat për marrjen e masave mbrojtëse lidhur me produktet që importohen në Kosovë në sasi të madhe apo që shkaktojnë dëm, apo kërcënim serioz ndaj prodhuesve vendorë. Këto masa duhet të jenë masa të përkohshme dhe në kontinuitet, në mënyrë që të mos bien ndesh me ligjet tjera. Dhe, këto masa do të duhej që me masa dhe me strategji zhvillimore të ndihmohet në forcimin e ekonomisë dhe sa më pak që të shfrytëzohen këto, por të zhvillohet ekonomia dhe të forcohen bizneset që të jenë në gjendje të marrin pjesë në

ekonominë globale. Në fakt, Kosova e ka Ligjin antidamping, i cili i rregullon importet të cilat me çmim të ulët shkaktojnë një konkurrencë jo fer. Dhe, ky ligj, së bashku me Ligjin antidamping dhe të tjerë do të duhej që të përbënte një tërësi për mbrojtjen e prodhuesve tanë, sepse prodhuesi kosovar ka qenë i ballafaquar me rreziqet nga importi i produkteve të ngjashme në shumë raste nga vendet të cilat kanë stimuluar prodhuesit e vet dhe prodhuesi kosovar ka qenë në një pozitë jo të favorshme në këtë treg të biznesit.

Masat ndërmerren pas hetimeve të kërkuara nga një prodhues apo nga një grup i prodhuesve të cilët përbëjnë mbi 50% të prodhimit vendor dhe pjesa më e madhe e ligjit i cili ka vetëm 30 nene, në fakt ka të bëjë me nene për hetim, për procedura, për mënyrën, për kohëzgjatjen e tjera. Vetëm pjesa e fundit i shpjegon masat dhe ato kohëzgjatjen, të cilat masa, e tjera.

Këto masa duhet të merren si veprime emergjente apo në raste të jashtëzakonshme, duke pasur kujdes edhe në udhëzimet dhe marrëveshjet që i përkrah Organizata Botërore e Tregtisë dhe pas vitit të parë, sipas këtyre udhëzimeve, masat duhet të nisin liberalizimin progresiv.

Në qoftë se i analizojmë nenet, shohim se në nenin numër 2, neni i cili flet për fushën e zbatimit, duhet të ketë njëfarë riformulimi, sepse në atë nen thuhet që ky ligj nuk zbatohet ndaj produkteve të importuara sipas ligjeve tjera të RKS-së. Atëherë duhet të përcaktohen më saktë se cilat janë ato produkte dhe ku ky ligj zbatohet e nuk zbatohet nga ligjet tjera.

Duhet të definohet cilat masa janë, përveç asaj të pagesës shtesë apo garancionit bankar, i cili është i përcaktuar në këtë ligj, por nga analiza e ligjeve tjera të vendeve tjera shihet që masat nuk duhet të jenë vetëm masat me ngritjen e tarifës për ato produkte të cilat e rrezikojnë rënd prodhimin kosovar apo ekonominë kosovare, por duhet të jenë edhe masa çfarë janë kuotat e eksportit me vende nga importohen ato produkte dhe masat tjera të cilat do ta bënin këtë ligj më të përshtatur për ekonominë vendore.

Gjithashtu, nenet 2.9.1, pikë 2 dhe pikë 3 duhet të përcaktohen më saktë ato afate se kur dhe si, në çfarë mënyre këto hetime mund të zgjasin dhe këto masa mund të jenë në fuqi.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah në parim Ligjin për masat mbrojtëse të importit, shqyrtimin, ndryshimet eventuale dhe amendamentet do t'i bëjë përmes deputetëve të vetë në komisionin funksional.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, s’ka të paraqitur. Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministër dhe ministra,

Edhe Grupi i Aleancës ka shqyrtuar këtë projektligj dhe mendon se me këtë projektligj do të bëhet mbrojtja e prodhuesve vendorë nga produktet e importuar dhe me këtë do të rritet, shpresojmë, eksporti dhe do të zvogëlohet deficitit tregtar, që është mjaft negativ. Në këtë projektligj thuhet se është sponsorizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,

në bashkëpunim me Zyrën ligjore dhe mund të them lirisht se Zyra ligjore i ka lëshuar disa gabime mu ligjore për arsye se në nenin 6 dhe 7 përdorë termat, se juristët shumë e kritikojnë, “mundet” dhe “duhet”, që s’duhen të përdoren në ligj. Gjithashtu, duhet thënë se ky ligj ka implikime buxhetore pasi këtu ministri i Buxhetit dhe Financave është, do të japë që të fillojë të zbatohet në vitin 2012, diku me shumë 32.000 euro, mirëpo besojmë se ky ligj do të gjejë edhe buxhet që të implementohet, prandaj Grupi i Aleancës përkrah në parim dhe kontributin do ta japë në komisionet që do të kalojë ky projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Koalicioni për Kosovën e Re e ka shqyrtuar Projektligjin për masat mbrojtëse në import. Duke marrë parasysh se Kosova akoma nuk është anëtare e OBT-së, duhet të plotësojë një infrastrukturë ligjore e cila i mundëson pikësëpari ruajtjen e bizneseve vendore dhe prodhimeve vendore, të cilat mund të bëhen me këtë ligj dhe nxitjen e eksportit, mirëpo në bazë të rregullave të tregut dhe konkurrencës, duke marrë parasysh se janë disa vërejtje, si potencoi edhe kolegu pak më parë, vërejtjet e juristëve në këtë projektligj, Koalicioni për Kosovë të Re e jep përkrahjen në parim dhe të gjitha vërejtjet do t’i adresojë në komisionin parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, deputeti Damka!

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim sayın Meclis başkanı,

Kosova’da yerli üretimi korumak ve Kosova şirketlerin kendi ürünlerini geliştirmek ancak ithalat engelleyici ve kısıtlayıcı yasanın yürürlüğe girmesi ile olacaktır. Bu yüzden bu Yasa Teklifi son derece önemli. Kosova’da yerli üretimi riske atacak benzeri malların ithalatının durdurulması Kosova ekonomisi açısından ileriye doğru atılacak önemli bir adım olduğunu düşünmekteyiz.

Bu Yasa yürürlüğe girdiğinde ithalatt firmalarının da zor durumda bırakılmaması için özenle dikkat edilmesi gerekecektir. Kosova ekonomisinde rekabetin olması bu tür Yasa ile az da olsa engellenmektedir. O yüzden Yasanın dikkatlice incelenip eklemelerin yapılması gerekmektedir. Rekabet ortamı ve zemini de yaratılmalı. Rekabet tüketici açısından olumlu sonuçlar doğurmaktadır, bu yüzden hem kalitenin hem de fiyatın tüketici açısından olumlu geliştiğini görebilmekteyiz. Devlet Kosova’daki firmaların, dış firmalar ile rekabet edebilmesi için yerli firmalara destek sunmalı, teşvik etmeli. Bunun da metodlarını Bakanlıklar aramalı. Genel itibariyle Yasanın önemli olduğunu düşünerek 6+ Parolmenter Grubua dına Yasa Teklifini desteklemekteyiz.

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj se Qeveria do ta mbështes Kuvendin, idenë që ta rregullojmë klimën pak, se vërtetë dimrit ftohtë e verës nxehtë dhe deputetë s’po mund të rrinë në sallë krejt, kështu që po presim deri sa të bëhet tamam kuorumi. Atëherë, në sallë erdhën dhe u bën 63 deputetë. Zoti Kuçi, nuk dëshironi më? Atëherë, në sallë janë 63 deputetë dhe votojmë tani:

Faleminderit! Me 59 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për masat mbrojtëse të importeve. Kërkohej nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës, që është:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti zëvendëskryeministër, e keni fjalën!

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Ky projektligj ka për qëllim të sigurojë mënyrën efikase transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimeve të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të gjitha fondet dhe burimet tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese dhe organet publike që zhvillojnë, përfshijnë ose marrin pjesë apo interesohen me aktivitetet e prokurimit ose që përfshijnë ose që kanë të bëjnë me fondet e burimet e ngjashme.

Meqenëse gjatë zbatimit të ligjit ekzistues janë vë në pah disa mangësi, në këtë rast ka lindur nevoja që të rishikohet ligji ekzistues dhe me qëllim që të eliminohen ato mangësi, është mundësuar dhe është dhënë si propozim ky projektligj.

Në këtë projektligj do të sigurohet integriteti dhe përgjegjësia e zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë përfshirë në një aktivitet të prokurimit publik, duke kërkuar që vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore faktike për vendimet e marra të mos ndikohen nga interesat personale, nga ato politike apo të tjera dhe të rritet shkalla e transparencës.

Projektligji për prokurim publik, ndër të tjera, rregullon detyrat specifike të zyrtarëve të prokurimit dhe po ashtu vlen të theksohet që autoritetet kontraktuese përfundimisht janë përgjegjës për të siguruar që aktivitetet e tyre të prokurimit të kryhen në mënyrë të drejtë dhe efektive për të siguruar vlerën për paranë.

Përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës për prokurim publik, për kontratat me vlera të mesme dhe të mëdha autoritetet kontraktuese duhet gjithashtu të nënshkruhen në emër të

autoritetit kontraktues nga zyrtari kryesor administrativ, gjegjësisht ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik, kështu duke i bërë llogaridhënës autoritetet kontraktuese.

Ky është edhe një propozim që është dhënë nga Komisioni Evropian dhe Qeveria e Kosovës e ka proceduar në Kuvendin e Kosovës. Presim që të japim mendimet, sugjerimet dhe të procedohet më tutje ky projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pas prezantimit, hap debatin për diskutim. Sipas radhës, kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputetja Hadërgjonaj!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Me Ligjin për prokurimin publik, që na është ofruar, janë përmirësuar rregullat dhe procedurat për shfrytëzimin në mënyrë më transparente dhe efikase të mjeteve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Me këtë ligj është rritur përgjegjësia e zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në aktivitetet e prokurimit, duke kërkuar që vendimet e individëve dhe baza ligjore dhe faktike për vendime të tilla të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo diskriminim, me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale të këtij ligji.

Gjithashtu, Ligji ka për qëllim krijimin e kushteve për ngritjen profesionale të zyrtarëve që merren me aktivitete të prokurimit, si dhe avancimin e rregullave të prokurimit dhe evitimin e mangësive në zbatimin e ligjit në praktikë.

Me Ligjin për prokurimin publik janë propozuar disa ndryshime, siç janë dhënë disa sqarime dhe formulime e përkufizime. Me qëllim që ligji të jetë më i qartë gjatë zbatimit, është paraparë detyrimi për organet e prokurimit si Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik, Organi Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe Agjencinë Qendrore të Prokurimit Publik që të publikojnë çdo akt nënligjor të prokurimit publik, në mënyrë që të rritet transparenca dhe të krijohet qasja, të krijohet mundësia e qasjes së publikut në dokumentet ligjore të prokurimit.

Detyrimi i çdo operatori që përfshihet në aktivitetet e prokurimit që të veprojë sipas rregullave të këtij ligji, pavarësisht hartuesit të tyre, janë shqyrtuar kompetencat e organeve të prokurimit, respektivisht të Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, janë përcaktuar kompetencat në mes të Komisionit Rregullativ të Prokurimit dhe Institutit të Kosovës për Administratë Publike lidhur me trajnimin e zyrtarëve të prokurimit dhe lëshimi i certifikatave, është specifikuar mënyra e nënshkrimit të kontratave të prokurimit publik, janë paraparë rregullat të detajizuara për zbatimin e kontratave të prokurimit.

Komisioni e ka shqyrtuar Ligjin për prokurimin publik dhe ka konstatuar se ligji formalisht i plotëson kërkesat formale për t'u proceduar në seancë në leximin e parë,

sepse përveç strukturës së standardizuar përmban edhe dokumente përcjellëse, si Deklaratën për përputhshmërinë me standardet e Bashkësisë Evropiane dhe Deklaratën financiare për implikimet buxhetore.

Sipas Deklaratës së Agjencionit për Integritet Evropian, ligji nuk i cenon parimet themelore të legjislacionit të Bashkësisë Evropiane. Ligj përmban rregulla ligjore, që sipas direktivave të BE-së siguron shfrytëzimin e fondeve në mënyrë transparente, efikase dhe të pa anshme.

Projektligji e ka deklaratën financiare dhe buxheti për zbatimin e këtij ligji është i paraparë me buxhetin e vitit 2011, dhe Ligji nuk përmban implikime shtesë buxhetore, për çka implikimet buxhetore janë të përballeshme për buxhetin e Kosovës.

Në bazë të këtyre që thashë më lartë, pasi që ligji i plotëson kushtet formale dhe përmbajtësore, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që të miratojë në parim këtë projektligj, kurse vërejtjet dhe sugjerimet do t'i marrë parasysh gjatë amendamentimit të projektligjit në faza të mëtejshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, përfaqësuesit e partive politike. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës dhe në parim e mbështet. Kontributin tonë do ta japim nëpër komisionet parlamentare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministrat, zëvendëskryeministrin dhe të gjithë kolegët deputetë!

Grupi Parlamentar i LDK-së ka analizuar këtë projektligj dhe ka shumë vërejtje për të. Korrupsioni si fenomen më negativ që i karakterizon të gjitha institucionet tona lidhet drejtpërdrejt me prokurimin publik. Kosova vuan shumë nga keqpërdorimi dhe keqmenaxhimi i parasë publike, por jo vetëm i parasë, por edhe i institucioneve, pozitive zyrtare dhe kapitalit të pasurisë publike në përgjithësi.

Qytetarët e Kosovës e paguajnë çmimin për të gjitha këto dukuri negative sepse janë ata që paguajnë taksa për rrugë, shkolla, spitale më të mira, por në vend të tyre paratë e qytetarëve shkojnë në standardin e lartë dhe në jetën bizare të një numri të vogël njerëzish që udhëheqin me institucionet ose kanë lidhje të drejtpërdrejta me to.

Ne jemi përpjekur të bëjmë një analizë të shkurtër të projektligjit të prokurimit publik, duke krahasuar ligjin me ligjin i cili është në fuqi dhe me disa ligje të tjera me të cilat ka kundërthënie të theksuara. Në vazhdim, do të prezantoj vetëm disa nga vërejtjet tona substanciale dhe kontributi ynë do të vazhdojë në komisionin funksional, ku do të propozojmë amendamente në mënyrë që ky ligj të jetë në shërbim të të gjithë qytetarëve.

Ne kemi vërejtje për ligjin, vërejtje të përgjithshme dhe vërejtjet që kanë të bëjnë me nene të caktuara të cilave do t'u referohemi.

Për shembull, te neni 3, i cili flet për përjashtimet. Në nenin 3 Qeveria lë mundësinë që të kemi prapë kontrata të llojit të Bechtelit, ku vetëm ministri dhe kryeministri mund të dinë çmimin e kontratës. Këtë nen ne e kundërshtojmë dhe nuk mund të pranojmë që institucionet e Kosovës të bëhen viktima të kompanive që kanë sekrete të çfarëdo natyre.

Ligji i prokurimit publik është për paranë dhe pasurinë publike dhe për shfrytëzimin e tyre qytetarët kërkojnë transparencë të plotë.

Tjetër, në Projektligj nuk është përfshirë fare çështja e afateve të kontratave, sa duhet të jetë kohëzgjatja e kontratës? Në praktikën e prokurimit në Kosovë merret vetëm si praktikë e mirë ndërkombëtare që kontrata mund të jetë dyvjeçare. Edhe në të kaluarën nuk ka qenë e rregulluar kohëzgjatja e kontratës, ka qenë 1 plus 1 vit, me mundësi të vazhimit por kjo është shfrytëzuar vetëm si praktikë e mirë ndërkombëtare.

Mos rregullimi i afatit kohor të kontratës po bie në kundërshtim edhe me ligjet tjera, si për shembull me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, Ligji numër 03-L/226, i dekretuar nga Presidenti i Kosovës më 9.11.2010. Është rregulluar si bazë për procesin e qiradhënies, është Ligji i prokurimit.

Neni 5 paragrafi 2 i jep të drejtë komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në kohëzgjatje prej 10 viteve, ndërsa paragrafi 3 i nenit 5 të këtij ligji i jep të drejtë komunës që të japë në shfrytëzim pronën më gjatë se 10 vjet, por jo më shumë se 40 vjet.

Nëse e shohim me kujdes Draftligjin e prokurimit publik, atëherë kuptojmë se ky Ligj i prokurimit publik, i propozuar, është në kundërshtim me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, dhënien me qira ose në shfrytëzim, në kuptimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe kjo duhet të rregullohet me nen të veçantë. Pra, ky dallim esencial duhet të harmonizohet patjetër, sepse nuk mund të kemi për një çështje të njëjtë të ketë dy ligje të ndryshme, të cilat rregullojnë në mënyra të ndryshme problematikën e njëjtë.

Neni 26, në këtë nen është paraparë nënshkrimi i kontratave të bëhet nga zyrtari i prokurimit, zyrtari kryesor administrativ, gjegjësisht ministri dhe në bazë të këtij neni ata marrin përgjegjësi së bashku.

Ky nen mund të shihet nga disa pikë vështrimi. Mund të shihet edhe si marrje e përgjegjësisë nga nivelet më të larta, mirëpo mund të shihet edhe si tendencë e

centralizimit dhe bartjes së përgjegjësisë në nivel më të lartë, e cila në shumicën e rasteve nuk do të funksionojë. Kemi marrë si shembull Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ministri i Punëve të Jashtme nuk do të ketë kohë të mjaftueshme me procedura tenderuese, sidomos me ato që kanë të bëjnë me blerjen e ambasadave, duke marrë parasysh se në këtë ligj nuk është prekur fare çështja se si do të zbatohen procedurat e këtyre shteteve. Ai duhet të merret me punë më të rëndësishme.

Ky ligj i bën ministrat përgjegjës për të gjitha keqpërdorimet në dikasteret përkatëse. Me këtë ligj Qeveria shpreh dy dobësi. E para, dobësinë e ministrave dhe udhëheqësve të institucioneve tjera për të mbajtur përgjegjës vartësit e tyre dhe, e dyta, mund të kuptohet si tendencë për participim të drejtpërdrejtë në keqpërdorimin e parasë publike e cila po ndodhë sot.

Rekomandimi ynë apo si një alternativë kishte për të qenë që Qeveria t'i bëjë funksionale organet e mbikëqyrjes. Këtu mendohet pikësëpari që institucionet e auditimit, vërejtjet, shkeljet ligjore dhe keqmenaxhimin dhe keqpërdorimet e rënda të cilat i konstaton auditori duhet t'i dërgojnë në prokurori, e jo të mbeten si raporte në sirtarë.

Neni 36 për kuotimin e çmimeve është konfuz dhe lë hapësirë për manipulim. Ne propozojmë që ky nen të qartësohet dhe të jetë më i shkurtër. Pjesën më të madhe të asaj çfarë e thonë nëntë paragrafët e këtij neni, e thotë vetëm paragrafi 9.

Neni 52, Njoftimi i kriterëve për dhënie të kontratës. Ky nen lë hapësirë për manipulim, gjithashtu. Ligji duhet t'i obligojë kontraktuesit që të publikojnë kriteret e vlerësimit dhe peshën e secilit kriter para se të shpallet fituesi, ndoshta së bashku me ftesën për ofertë e jo më pas, sepse kjo lë hapësirë për dyshime. Ne ende e kemi të freskët rastin e tenderit për penjtë kirurgjikë nga Ministria e Shëndetësisë, ku tenderin e mori kompania që ishte 400.000 më e shtrenjtë. Athua, me çfarë arsytimi? Sigurisht se kompania ka thënë që penjtë e mi janë më të fortë dhe qëndrojnë më gjatë.

Neni 59 dhe neni 58, në këtë projektligj nuk është rregulluar çështja e komisionit të hapjes dhe komisionit të vlerësimit. Nuk përmendet vetëm komisioni, këtu përmendet vetëm komisioni i hapjes, ndërsa komisioni i vlerësimit nuk përmendet.

Është e domosdoshme që duhet të jetë... dhe është rregulluar këto çështje. Pra, duhet të jenë komisionet e ndara, me anëtarët e ndryshëm në komision të hapjes dhe të vlerësimit.

Neni 61. Tenderët jo normalisht të ulët. Kemi të bëjmë me një përkthim të dobët. Nuk e di se çfarë në të vërtetë është një tender jo normalisht i ulët. Nëse dikush din ta shpjegojë, kisha pasur dëshirë ta dëgjoj, por prapëseprapë nuk jam e sigurt se fjala tender jo normalisht i ulët i përgjigjet ndonjë përshtatimi të mundshëm dhe është adekuat në gjuhë shqipe.

Neni 62. Përfundimi i aktivitetit të prokurimit. Në këtë nen janë të rregulluara çështjet kur mund të anulohet një aktivitet i prokurimit. Në formularin e KRPP-së është saktësuar

arsyetimi si mund të anulohet një tender. Në raportin e vitit të kaluar për prokurim publik të dhënat janë se janë anuluar 82% e tenderëve në mungesë të tri ofertave, 8% janë anuluar për arsye objektive, 5% për shkak të tejkalimit të buxhetit. Arsye objektive duhet të jetë një arsye shumë e qëndrueshme dhe shumë e rëndësishme bindëse për anulimin e një procedure tenderuese. Prandaj kjo mënyrë e anulimit të procedurës tenderuese që ka ndodh në të kaluarën rekomandohet të rregullohet me ligj, duke paraparë masa ndëshkuese, duhet të dënohet zyrtari i prokurimit ose komuna apo ministria. Çka ka ndodhur deri më tani, tenderët janë anuluar nëse nuk ka mund të shpërblehet njeriu i duhur apo miku i dikujt. Atëherë është bërë anulimi i tenderit.

Neni 85. Në këtë nen, 4 herë përmendet fjala “ministri i Ministrisë përkatëse për Financa”, që i bie që çdo ministri ka ministër për financa, e që nuk është e vërteta, andaj edhe kjo duhet të rregullohet.

Gjithashtu, kemi nenin 106, ku kemi themelimin dhe përbërjen e paneleve shqyrtuese. Këtu është fjala për Organin Shqyrtues të Prokurimit, ku thuhet që kryetari i OPSH-së duhet të jetë përgjegjës për themelimin e rregullave të brendshme në lidhje me emërimin e anëtarëve të një paneli.

Ne mendojmë që duhet të krijohet një rregull në ligj. Nuk mund kjo të jetë kompetencë e kryetarit të OPSH-së që ai t’iu jep lëndët kujt ka qejf. Kjo duhet të rregullohet si në gjykata ose të bëhet me short.

Neni 107. Rregullorja e procedurave të organit shqyrtues të prokurimit. Prapë këtu kemi me të bëjmë me një kompetencë të paarsyeshme të kryetarit. Nuk është kryetar ai i cili duhet ta bëjë rregulloren e OPSH-së, po është OPSH-ja ajo e cila duhet ta bëjë rregulloren.

Dhe, gjithashtu, një vërejtje në nenin 118, ku të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OPSH në vlerën prej 500 euro. Mendojmë që kjo shumë është e lartë dhe duhet të zbritet deri në 100 euro, sepse në këtë mënyrë ne vetë diskurajojmë operatorët ekonomikë për t’u ankuar në OPSH.

Unë, si pjesë e Grupit punues të këtij ligji, meqenëse jam pjesë e komisionit funksional, ju bëj thirrje të gjithëve që vërejtjet e juaja sa më shpejt t’i dorëzoni me shkrim, në mënyrë që neve ta bëjmë një ligj të implementueshëm dhe një ligj i cili është në shërbim të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Ne, si Grup Parlamentar do ta përkrahim në parim, por do të jemi shumë vigjilentë gjatë amendamentimit të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk ka të paraqitur. Grupi Parlamentar AAK, deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

Ndoshta ky ligj është dashur të diskutohet në një rrethanë tjetër, kur kishim pasur pak më shumë koncentrim dhe kishim punuar pak më shumë në të, por megjithatë unë për shkak të rrethanave në të cilat po zhvillohet kjo seancë, do të them vetëm dy-tri fjalë, ndërsa 6 rekomandimet e Grupit Parlamentar të Aleancës do t'i dorëzojmë me shkrim në komisionin përkatës.

Pajtohemi të gjithë se reformimi i sferës së prokurimit publik është domosdoshmëri dhe ka ndikim të madh në shkallen e uljes së korrupsionit në vend. Pra, është sferë shumë e kritikuar edhe në Raportin e progresit për Kosovë të Bashkimit Evropian, por edhe përvojë e hidhur e shumë operatorëve ekonomikë, të cilët në mungesë, do të thotë për shkak të boshllëkut ligjor dhe praktik në këtë fushë, janë ballafaquar me pengesa të shumta dhe implikime burokratike, të cilat kanë stimuluar korrupsionin dhe kanë dëmtuar rrjedhimisht biznesin dhe ekonominë e vendit.

Është domosdoshmëri jetike që të ndërhyhet në këtë sferë dhe ne e mirëpresim ligjin, edhe pse u tha edhe nga kolegët e tjerë, ka shumë mangësi, mirëpo konsiderojmë që hapësira kohore prej leximit të parë në lexim të dytë do të angazhojë një numër të madh të grupeve punuese, të cilat seriozisht do të punojnë dhe thellësisht në ndryshimin e këtij projektligji në mënyrë që, do të thotë, të gjitha ato të meta të shumta të evitohen dhe të kemi një ligj të mirë.

Grupi Parlamentar i Aleancës, në parim e mbështet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, deputetja Novobërdaliu!

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryesues! Edhe Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për prokurimin publik, të njëjtin në parim e përkrahim, vërejtjet eventuale do t'i japim komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, Damka!

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkan yardımcısı,

Kamu alımlar yasası bugüne kadar var olan Yasanın eksikliklerini dolduracak ve tamamlayacak olması Kosova devlet kurumlarında bu tür işlemlerde bugüne kadar doğan sorunların ortadan kaldırılacağına inanmaktayız. Yasanın tüm şirketlere, devlet alımları ihalesinde eşit bir şekilde yaklaşımı öngörmesi, herhangi bir husus veya olanak vermemesi ve Avrupa standartlarına göre hazırlanmış olması bizleri memnun etmektedir.

Bunun yanında Yasa, devlet kurumlarının alımında daha detaylı ve doğru yapılabilmesine de olanak sağlamaktadır. Yasa'nın 134. maddesinde ihalelerde kullanılacak dillerle ilgili düzenlemeyi öngörmektedir. Kosova resmi dillerinde öngörülen Yasa Teklifine ön öneri olarak Türkçenin de girmesini talep etmekteyiz. Bunu talep ederken bunu somut olarak Kosova piyasasında ciddi ve büyük Türk firmaların faaliyetlerinin var olması ve piyasaya

getirmiş oldukları mal çeşitleri ile ekonomik olarak büyük bir yer tutmaktadır. Bu yüzden devlet ihalelere Türkçe dilinde katılmaların sağlanması Kosova'nın ekonomik çıkarı açısından karlı olacağına inanmaktayız.

6+ Parlamenter Grubu adına Yasa Teklifini desteklediğimizi ve somut önerilerimizi komisyona sunacağımızı bildirmek istiyorum.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kuçi, a dëshiron, ndonjë shtesë? Zoti Kuçi e ka fjalën!

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar deputet dhe grupe parlamentare!
Ndoshta më lejoni vetëm deputetes Bajrami t'ia jap një përgjigje të shkurtër për çështjen që e ngriti.

Nëse na pyetni neve në Qeveri, unë besoj se edhe herën e kaluar ka qenë kështu, nuk ka pasur vullnet që ne t'i nënshkruajmë kontratat e tilla. Ne kemi bërë një qëndrim të tillë mbi bazën e kërkesës së Komisionit Evropian, e herën e kaluar ju e dini që ka qenë në qeveri mu ai nen dhe mu ashtu njerëzit e Qeverisë kanë votuar kundër atij neni, kjo nuk do të thotë se është vullnet për të ndërhyrë, se është përgjegjësi e lartë, por e rrit shkallën e përgjegjësisë të secili zyrtar publik, përfshin njerëzit e Qeverisë, por edhe zyrtarët tjerë, përfshirë edhe ata në komuna, por edhe ata në organizatat apo agjencione të pavarura.

Unë mendoj që edhe në media është hapur një debat i tillë. Unë i kam ftuar njerëzit e mediave të kontaktojnë Komisionin Evropian dhe janë pajtuar me një qëndrim të tillë.

Unë po ashtu i ftoj edhe tani deputetët e Kuvendit, për hir të rrethanave që kemi në raport me Komisionin Evropian ne do ta marrim një përgjegjësi shtesë të gjithë zyrtarët, jo vetëm në Qeveri, kjo vlen tash edhe për komuna, agjencione të pavarura dhe në Kuvend, po ashtu. Unë jam i bindur se duhet të procedohet, ndërsa kontributi për një ligj më të mirë unë besoj se është i mirëseardhur për të gjithë ju.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë diskutues. Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim për miratim të Projektligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Në sallë janë prezent 61 deputetë. Lus regjinë dhe juve, të nderuar deputetë, që të bëjmë votimin dhe votojmë tani:

Faleminderit! Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizimin sindikal

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për organizimin sindikal dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj raportuesen e komisionit funksional për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, deputeten Salije Mustafan që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SALIJE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!
I nderuari zëvendëskryeministër,
Ministra të nderuar,
Kolegë deputetë...

KRYESUESI: Ju lus, të nderuar deputetë, ne nuk kemi deputetë të mjaftueshëm për votim. Vetëm në qoftë se një del jashtë, unë jam i detyruar ta ndërpres seancën. Ose rrini në sallë për të votuar, ose nuk mund të shkojmë... Do të fillojmë me amendamente. Ju lus! Janë vetëm 61 deputetë në sallë. 59 deputetë. Unë në qoftë se nuk bëhen 61 unë e ndërpres seancën.

SALIJE MUSTAFA: Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale, në mbledhje të mbajtura e ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka pasur mjaft debate për këtë projektligj.

Projektligji nga të gjithë anëtarët e komisionit është i konsideruar si shumë i rëndësishëm për funksionimin e sindikatave në Kosovë. Në komision është diskutuar dhe ka pasur propozime për ndryshimin e disa çështjeve thelbësore. Komisioni ka votuar unanimisht amendamentet dhe kërkojmë nga anëtarët e Kuvendit që t'i votoni amendamentet e këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Sa janë deputetë? Nuk shkohet më tutje, unë nuk e di a vijnë a s'vijnë. Në dasmë s'e kam thirr askënd. E ndërpresim seancën dhe fund.
Atëherë, në sallë janë 61 deputetë dhe vazhdojmë votimin e amendamenteve të propozuara. Do të votojmë me procedurë të shpejtë.

Amendamenti 1.

Votojmë tani:

63 deputetë janë në sallë. Regjia zvogëlo matjen e kohës, sepse 10 sekonda është shumë.
Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Miratohet.

Amendamenti 3.

Miratohet.

Amendamenti 4.

Miratohet.

Amendamenti 5.

Miratohet.

Amendamenti 6.

Miratohet.

Amendamenti 7.

Miratohet.

Amendamenti 8.

Miratohet.

Amendamenti 9.

Miratohet.

Amendamenti 10.

Miratohet.

Amendamenti 11.

Miratohet.

Amendamenti 12.

Miratohet.

Amendamenti 13.

Mos harroni të votoni!

Miratohet.

Amendamenti 14.

E drejtë është të abstenohet, jo të mos votohet!

Miratohet.

Amendamenti 15.

Miratohet.

Amendamenti 16.

Miratohet.

Amendamenti 17.

Miratohet.

Amendamenti 18.

Miratohet.

Amendamenti 19.
Miratohet.

Amendamenti 20.
Miratohet.

Amendamenti 21.
Miratohet.

Amendamenti 22.
Miratohet.

Amendamenti 23.
Miratohet.

Amendamenti 24.
Miratohet.

Amendamenti 25.
Miratohet.

Amendamenti 26.
Miratohet.

Amendamenti 27.
Miratohet.

Amendamenti 28.
Miratohet.

Amendamenti 29.
Miratohet.

Amendamenti 30.

Amendamenti 31.
Miratohet.

Amendamenti 32.
Miratohet.

Amendamenti 33.
Miratohet.

Amendamenti 34.
Miratohet.

Amendamenti 35.
Miratohet.

Amendamenti 36.
Miratohet.

Amendamenti 37.
Miratohet.

Të nderuar deputetë, tani votojmë Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 1 abstenim, asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për organizimin sindikal.
Në sallë janë 62 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

12. Shqyrtimi i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim dhe Kuvendi i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, kryetaren e Komisionit Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Pas miratimit në parim të Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me Rregulloren e punës të Kuvendit, me qëllim të shqyrtimit dhe propozimit të ndryshimeve të Projektligjit ka krijuar grupin punues.

Grupi punues ka mbajtur disa takime, të cilat janë zhvilluar në bashkëpunim me ekspertët e fushës së caktuar dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave. Grupi punues ka harmonizuar qëndrimet për ndryshimet dhe plotësimet e Projektligjit, të cilat janë propozuar në formë të amendamenteve dhe si të tilla janë miratuar unanimisht në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ju ftoj që t’i miratoni amendamentet të cilat janë propozuar nga komisioni.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në Raportin e komisionit funksional.

Nuk ka kuorum!

Atëherë, mendoj se nuk është fer kështu, sepse edhe ne kemi shpirt dhe kështu... Unë nuk mund t'ua heq se s'e kam të rregulluar personalisht por mendoj se duhet ta ndërpresim seancën. Nuk ka kuorum, vazhdojmë nesër në orën 10:00.

E premte, 29.7. 2011, ora 10:00, vazhdimi i seancës së djeshme
Drejton seancën: nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Mirëmëngjesi!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, filluar më 28 korrik 2011.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 66 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Tani unë dua t'ju njoftoj që në të dyja pikat e rendit të ditës kemi për t'ju miratuar 180 amendamente të ligjeve, duke përjashtuar në këtë rast ligjet që janë në lexim të parë. Prandaj, ju kisha lutur që nëse doni ta kryejmë sot seancën, qëndroni, mos ta lëshojmë sallën si dje dhe të mos kemi nevojë që nesër ta mbajmë prapë vazhdimin e seancës, sepse jemi të detyruar që në qoftë se sot nuk e kryejmë, nesër ta vazhdojmë. Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Kemi ngelur në procesin e votimit. Fillojmë menjëherë. Kemi disa pika për shembull të kjo- Deklarimi i komisioneve lidhur me amendamentet. Në qoftë se nuk ka ndonjë çështje kontestuese, është mirë që ta kapërcejmë. Zoti Hamiti, e ka kërkuar fjalën.

SABRI HAMITI: Propozim për procedurë.

Zoti kryesues, meqë ka shumë amendamente, meqë jemi të interesuar t'ju kalojmë me ritëm më të shpejtë dhe kur nuk ka diskutime, unë propozoj që të votojmë me dorë se shkon më shpejt, me ngritje dore.

KRYESUESI: Faleminderit!

SABRI HAMITI: Pyeti, unë mendoj njësoj është ajo, e drejtë e Kuvendit është të vendosë.

KRYESUESI: E njëjta gjë, thotë më shpejt, është e vërtetë. Atëherë, ne mund të procedojmë me votim të amendamenteve me dorë dhe në fund ligjin e votojmë me

elektronikë, këtë mund ta praktikojmë. A ka dikush “kundër” apo jeni që ta praktikojmë këtë mënyrë të votimit. A ka “kundër”? Domethënë, nuk ka “kundër”.
Atëherë, fillojmë votimin me dorë të amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 9.

Zoti Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit!

Shumë shkurt, zoti nënkryetar.

Amendamenti 10 ka të bëjë me shtimin ose mos shtimin e një anëtar i në komision nga Shoqata e Kontabilistëve të certifikuar dhe nëse mbetet ashtu si ka ardhur prej Qeverisë në Komision, do të jetë një anëtar dhe mendoj që duhet të jetë. Kështu që kisha ftuar deputetët që këtë amendament të mos e votojmë, në mënyrë që të kthehet ashtu si ka qenë për shkak se do të ishte mirë që në komision, për të cilën po flasim në këtë ligj, të jetë një anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, janë dy propozime, në fillim kemi propozimin e komisionit, votojmë me elektronikë, pra. “Për” votojmë Komisionin në fillim dhe “kundër” nëse ka më shumë “kundër”, është propozimi i zotit Gjini. Votojmë tani në dy variantet amendamentin 10, propozimi i komisionit është “për”, domethënë varianti i parë dhe votimi për propozimin e zotit Gjini është “kundër”. Votojmë tani: Në sallë janë 74 deputetë.

Faleminderit! Shkon propozimi i zotit Gjini me 37 vota, bie i komisionit me 28 vota.

Vazhdojmë amendamenti 11.

A ka “kundër”?

Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

A ka “kundër”?

Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Ka zoti Zemaj, për amendamentin 17 a e pate fjalën?

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, shumë!

Edhe unë propozoj që amendamenti 17, i miratuar nga komisioni funksional, të mos miratohet, po të mbetet ashtu si ka qenë në ligj për arsye se Shoqata e Kontabilistëve

duhet të jetë anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve të certifikuar, sepse e ruan kredibilitetin dhe performancën pozitive të auditimit në Republikën e Kosovës.

Fatkeqësisht, unë kam qenë edhe anëtar i Grupit punues së bashku me Valbona Dibra, nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave dhe kemi dhënë këtë shqetësim, për arsye se devalvimi i kësaj vlere dhe tendenca që të shndërrohen “po thuaj se” sikurse mos ta krahasoj me shumëllojshmërinë e universiteteve private, tregon qartë që këtu kemi një pengesë serioze në auditimin i cili është një element shumë kryesor në kontrollin e brendshëm të institucioneve të kompanive private, raportimit të rregullt financiar e të tjera, prandaj propozoj që të mbetet ashtu siç është në ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kryetarja e Komisionit, Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Është e vërtetë që Grupi Punues i Komisionit për Buxhet dhe Financa ka punuar në bashkëpunim me Grupin Punues të Komisionit për Mbikëqyrjen dhe ky amendament, respektivisht ndryshimet që janë bërë në nenin 22 kanë qenë të pa precizuara. Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka diskutuar gjatë këtë nen, nenin 22. Në Komision, në Grupin punues kanë qenë të angazhuar edhe një numër i caktuar ekspertësh, të cilët e njohin mirë këtë lami. Sipas deklaramit të ekspertëve, në asnjë vend nuk është e përcaktuar me ligj që duhet të jetë anëtar i Fondit Ndërkombëtar të Kontabilistëve për t’u licencuar një shoqatë e kontabilistëve. Megjithatë, ne kemi ardhur në përfundim në Komisionin për Buxhet dhe Financa që për t’u licencuar një shoqatë, duhet t’i plotësojë të gjitha rekomandimet të cilat janë lëshuar nga Fondi Ndërkombëtar i Kontabilistëve për të qenë e licencuar. Ky amendament, i cili është propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, është i përkrahur njëzëri nga të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet, domethënë të gjithë kanë qenë pro që të shkohet në këtë variant. Fundja, vendimin përfundimtar e merr Kuvendi, si të votojë Kuvendi, ajo bëhet e fuqishme. Mirëpo, unë dua ta them mendimin që në Komisionin për Buxhetet dhe Financa të gjithë anëtarët kanë qenë pro që të shkohet në këtë variant.

KRYESUESI: Faleminderit!

Shkojmë me të njëjtin variant të votimit, votojmë “për”, domethënë vota “për” është për komisionin, vota “kundër” është për propozimin, siç ishte më parë në votim, domethënë propozimin e Qeverisë që ka qenë ai amendamenti 17.

Regjia, bëhemi gati për votim, votojmë tani amendamentin 17.

Faleminderit! Me 41 vota “për”, 36 “kundër”, miratohet amendamenti 17 sipas propozimit të komisionit.

Amendamenti 18.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Miratohet amendamenti 18.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Në sallë janë 78 deputetë, votojmë tani: Faleminderit!

Konstatohet se me 70 vota “për”, 3 “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës, që është:

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kadastrën

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin për kadastrën dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis, Planifikim Hapësinor, deputetin Nait Hasani ose Liburn Aliu, qenka paraqitur që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

LIBURN ALIU: Të nderuar deputetë,

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka trajtuar Projektligjin për kadastrë. Në trajtimin e këtij projektligji janë angazhuar edhe dy ekspertë, njëri i lëmit profesional, pra për kadastrën dhe gjeodezinë, si dhe tjetri si ekspertë ligjor.

Gjatë trajtimit të projektligjit janë mbajtur takime të vazhdueshëm me ekspertët, janë marrë sugjerimet dhe vërejtjet nga komunat, nga ministrinë që lidhen drejtpërdrejt në këtë ligj, nga Shoqata e Gjeodetëve, organizata të shoqërisë civile, si dhe ekspertë të ndryshëm dhe të interesuar dhe të gjitha këto nëpërmes takimeve të ndryshme në Kuvend, si dhe seancës dëgjimore që është organizuar në hapësirat e Kuvendit.

Në trajtimin e këtij ligji në të gjitha mbledhjet e mbajtura po ashtu kanë qenë gjithmonë prezentë edhe përfaqësuesit nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, si dhe nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pra e tërë puna është bërë në bashkëveprim duke synuar që të bëhet, të nxirret një ligj sa më i mirë të themi.

Vërejtjet nga ekspertët të angazhuar për këtë projektligj kanë qenë mjaftë serioze. Projektligji, sipas ekspertëve, është i hartuar mjaftë dobët, posaçërisht në aspektin ligjor, në raport me parimet themelore kur krahasohet pra në raport me parimet themelore për hartimin e legjislacionit e që parashihet me nenin 36 të Rregullores së Punës së Qeverisë.

Vërejtje po ashtu ka pasur edhe për strukturimin e dispozitave të projektligjit që do të duhej t'i përmbahej kërkesave që dalin nga neni 7 i Udhëzimit administrativ 14/2008 për hartimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore.

Vërejtjet nga eksperti i lëmit që trajton projektligji kanë të bëjnë kryesisht me natyrën e funksionimit të kadastrit në Kosovë, që është totalisht i ndryshëm me praktikën e vendeve normale dhe kjo si pasojë e kushtëzimeve nga paketa e Ahtisarit që i trajton edhe regjistrat kadastral, te pjesa ku bëhet fjalë për decentralizimin. Po ashtu, nga ky ekspert

kemi pasur edhe vërejte të tjera për funksionimin, të cilat është synuar që të përmirësohen.

Në punën e Grupit Punues të Komisionit, përgjithësisht të gjitha këto vërejtje është synuar që të përmirësohen dhe sot tani Komisioni pra e rekomandon komplet projektligjin që të votohet, si dhe të gjitha amendamentet që janë parashtruar nga ky komision.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamenteve. Nuk ka diskutime.

Amendamenti 1.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.
Nuk ka “kundër”.
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Nuk ka vërejtje
Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.
Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 22.

Kemi përfunduar amendamentet një nga një. Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Në sallë janë 72 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim me elektronikë. Votojmë tani:

Faleminderit!

Konstatohet se me 62 vota “për”, 9 vota “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për kadastër. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 14-të të rendit të ditës, që është:

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për markat tregtare

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për markat tregtare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, në qoftë se ka ndonjë çështje ta ngrejë. Nuk ka.

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës të paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Amendamenti 1.

Nuk ka “kundër”.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Nuk ka “kundër”

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Nuk ka “kundër”

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.
Nuk ka “kundër”
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.
Nuk ka “kundër”
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
Nuk ka “kundër”,
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
Nuk ka “kundër”
Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.
Nuk ka “kundër”
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Nuk ka “kundër”
Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Nuk ka “kundër”
Miratohet amendamenti 12.
Faleminderit!

Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:
Në sallë janë 69 deputetë. Faleminderit!
Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për markat tregtare.

Vazhdojmë me pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për dizajnin industrial dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë, Komisioni nuk ka ndonjë vërejtje, nuk është paraqitur askush. Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Amendamenti 1.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 9.

Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.
Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.
Në sallë janë 68 deputetë. Votojmë tani. Faleminderit!
Konstatohet se me 65 vota “për” asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për dizajnin industrial.

Vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës, që është:

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patenta

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për patenta dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional dhe Zhvillim Ekonomik, nuk është paraqitur prapë askush, sepse nuk ka me siguri ndonjë vërejtje.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në komisionin funksional.

Amendamenti 1.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Nuk ka vërejtje

Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 10.

Votojmë tani tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Në sallë janë 68 deputetë, votojmë tani. Faleminderit!

Konstatohet se me 68 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për patenta.

Vazhdojmë me pikën shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës:

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për përdorim civil të eksplozivëve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputetin Anton Quni, nuk është paraqitur, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Nuk ka të paraqitur për të diskutuar.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Amendamenti 1.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Nuk ka vërejtje.

Miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Nuk ka vërejtje,

Miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.
Nuk ka vërejtje,
Miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 39.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42.
Nuk ka vërejtje.
Miratohet amendamenti 42.

Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani.
Në sallë janë 70 deputetë. Faleminderit!
Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për përdorim civil të eksplozivëve.

Konstatohet që seanca e djeshme e filluar, përfundoi. Do ta fillojmë seancën e re të Kuvendit. A jeni për një pauzë 10 minuta, apo të vazhdojmë?

Atëherë, konstatohet që po vazhdojmë menjëherë me seancën e re të Kuvendit.

Përgatiti:
Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës